



Republika e Kosovës - Republika Kosova - Republic of Kosova

ZYRA RREGULLATORE PËR UJËSJELLËS DHE MBETURINA
REGULATORNI URED ZA VODOVOD I OTPAD
WATER AND WASTE REGULATORY OFFICE



RAPORTI VJETOR

2011

Prishtinë
mars 2012

Vizioni

“Shërbime cilësore, dhe të qëndrueshme të ujësjellësit, kanalizimit dhe të mbeturinave për të gjithë qytetarët e Kosovës.”

Misioni

“Të bëjë Rregullimin e kompanive të ujësjellësit, kanalizimit dhe të mbeturinave në funksion të ofrimit të shërbimeve cilësore, efikase dhe të sigurta në përputhje me praktikat e mira Evropiane, veçanërisht duke u fokusuar në promovimin e efikasitetit, transparencës, shtrirjes së shërbimeve për të gjithë qytetarët, mbrojtjen e konsumatorëve, me çmime sa më të përballueshme për shërbimet e ofruara, gjithmonë duke pasur në konsideratë mjedisin dhe shëndetin publik.

Përmbajtja

PËRMBAJTJA	3
1. PARATHËNIE	4
2. STATUSI LIGJOR DHE PËRGJEGJËSITË E ZRRUM	6
2.1. AUTORIZIMET DHE PËRGJEGJËSITË E ZRRUM	6
2.2. STRUKTURA ORGANIZATIVE E ZRRUM	6
3. AKTIVITETET RREGULLATORE TË ZRRUM.....	8
3.1. LICENCIMI	8
3.2. MONITORIMI I PERFORMANSËS	13
3.2.1. PERFORMANCA E SEKTORIT TË UJËSJELLËSIT DHE MBETURINAVE	13
3.2.2. PERFORMANCA INDIVIDUALE E KOMPANIVE RAJONALE TË UJËSJELLËSIT	15
3.2.3. PERFORMANCA E PËRGJITHSHME E SEKTORIT TË GRUMBULLIMIT TË MBETURINAVE	20
3.2.4. PERFORMANCA INDIVIDUALE E KOMPANIVE RAJONALE TË MBETURINAVE	20
3.2.5. PERFORMANCA E KOMPANISË PËR MENAXHIMIN E DEONITË TË MBETURINAVE NË KOSOVË	24
3.3. TARIFAT E SHËRBIMIT	25
3.3.1. PËRCAKTIMI I TARIFAVE TË SHËRBIMIT TË UJIT DHE TË MBETURINAVE	25
3.3.1.1. PËRCAKTIMI I TARIFAVE TË SHËRBIMIT TË UJIT PËR VITET 2012-2014	25
3.3.1.2. TARIFAT E SHËRBIMIT TË ADMINISTRIMIT ME MBETURINA 2011-2012	28
3.3.2. MONITORIMI 9 MUJOR I TË DHËNAVE OPERATIVE DHE FINANCIARE I KRU`VE	30
3.3.2.1. TË DHËNAT OPERATIVE	30
3.3.2.2. TË DHËNAT FINANCIARE	31
3.3.2.3. MBULIMI I SHPENZIMEVE TË PËRGJITHSHME OPERATIVE NGA SHUMA E ARKËTIMIT	31
3.3.2.4. FATURIMI DHE ARKËTIMI	32
3.3.2.5. TË DHËNAT PËR INVESTIMET KAPITALE	32
3.4. PROMOVIMI I INTERESAVE TË KONSUMATORËVE	33
3.4.1. ZBATIMI I STANDARDEVE TË SHËRBIMIT	33
3.4.2. TRAJTIMI I ANKESAVE TË KONSUMATORËVE PËRMES KKK-VE	34
4. AKTIVITETET NË KONSOLIDIMIN INSTITUCIONAL	36
4.1. AKTIVITETET NË PLANIN LEGJISLATIV	36
4.2. MBËSHËTETJA INSTITUCIONALE NGA DONATORËT	39
5. RELACIONET E JASHTME.....	41
5.1. BASHKËPUNIMI ME RREGULLATORËT DHE INSTITUCIONET TJERA NË KOSOVË	41
5.2. BASHKËPUNIMI ME RREGULLATORËT E UJIT NË REGJION DHE NË EVROPË	42
5.3. BASHKËPUNIMI ME MEDIA - RELACIONET ME PUBLIKUN	42
6. ASPEKTET FINANCIARE.....	43
6.1. SHPENZIMET	43
6.2. MBËSHËTETJA NGA DONATORËT	43
6.3. TË HYRAT NGA TAKSAT E LICENCIMIT 2011	44
6.4. ASETET E ZRRUM	44
7. REKOMANDIME TË PËRGJITHSHME	45

1. Parathënie

Unë jam i kënaqur të paraqesë Raportin Punës së Zyrës Rregullatore për Ujësjellës dhe Mbeturina për vitin 2011, të katërtin me radhë.

ZRRUM, është institucion i pavarur me përgjegjësinë për rregullimin ekonomik të sektorit të shërbimeve të ujit dhe të shërbimeve të mbeturinave në Kosovë. Ne pra, kemi përgjegjësin për të informuar dhe japim llogari për Kuvendin e Republikës së Kosovës për aktivitetet tona, dhe po ashtu kemi punuar shumë për të mbajtur të informuar Qeverinë, Pushtetin Lokal, Konsumatorët Donatorët dhe Palët e tjera të interesit, për gjendjen e furnizimit me ujë të pijshëm, shërbime të ujërave të zeza dhe të shërbimeve të mbeturinave në Kosovë.

ZRRUM gjatë vitit 2011 përveç në aktivitete tjera të punës ka qenë i angazhuar në përcaktimin e tarifave të shërbimeve publike për ujësjellës dhe kanalizim dhe atë të grumbullimit të mbeturinave të ngurta komunale, si dhe për administrim të deponive të përhershme sanitare.

ZRRUM për shërbimet e ujësjellësit dhe kanalizimit për herë të dytë ka përcaktuar tarifa afatmesme tre (3) vjeçare 2012-2014, ndërsa për shërbimet e administrimit të mbeturinave të ngurta të njëjtat kanë vazhduar të përcaktohen vit pas viti.

Parimi bazë i ZRRUM-it gjatë përcaktimit të tarifave ka qenë krijimi i parakushteve për kompani efikente, duke pas në konsideratë edhe mundësinë e pagesës së faturave që konsumatorët i marrin nga to.

ZRRUM, në vitin 2011, ka bërë shqyrtimin e gjithanshëm të tërë procesit të Monitorimit të Aktiviteteve të Kompanive dhe ka zhvendosur këtë proces nga monitorimi i performancës për qëllime të Menaxhmentit, drejt kërkesave specifike Rregullatore, në nivele të veçanta të shërbimeve dhe implikimeve të kostove për konsumatorët.

Gjatë vitit kemi publikuar Raportin Vjetor të monitorimit të performancës për vitin 2010, dhe kemi komentuar progresin e kufizuar të cilin e kanë shënuar Ofruesit e shërbimeve të ujit dhe të mbeturinave, të cilat kryesisht lidhen me ngritjen e shkallës së arkëtimit, përderisa në shumicën e treguesve kyç nuk është shënuar ndonjë progres.

Në vitin 2011, sektori i shërbimeve të ujësjellësit ka shënuar progres në disa prej TKP, krahasuar me vitin 2010, sidomos evidente është progresi i vazhdueshëm në shkallën e arkëtimit edhe pse jo me një përqindje të dëshiruar, përmirësime janë shënuar në rritje të konsumit të matur, si dhe mbulueshmëria e shpenzimeve operative nga të ardhurat totale. Shqetësim ynë i vazhdueshëm mbetet Uji i Pa Faturuar (UPF), i cili me nivelin aktual prej 61%, është i pa akceptueshëm në krahasim me një nivel të pranueshëm ndërkombëtar prej 25%. Gjithë ashtu sfiduese janë ndërprerjet e shpeshta të furnizimit me ujë, si dhe investimet e ulëta në këtë sektor.

Në sektorin e shërbimit të mbeturinave gjendja shihet si më e keqe. Në përgjithësi të gjitha kompanitë kanë performuar më dobët në vitin 2011, në raport me vitin 2010, në po thuajse të gjithë TKP, janë shënuar trende negative, sidomos sfiduese është eficaenca e arkëtimit dhe ngritja e vazhdueshme e shpenzimeve operative. Aktualisht asnjë prej kompanive të mbeturinave nuk janë në gjendje të qëndrueshme financiare për ti mbuluar shpenzimet operuese me të hyra kesh.

Gjatë vitit 2011 ne kemi qenë në zhvillimin e të menduarit tonë se si ne të përmbushim detyrën tonë të zhvillimit të qëndrueshëm dhe pas një pune intensive të stafit të ZRRUM dhe mbështetjes

së konsulencës (IPA), në vitit 2011, është hartuar Planin Strategjik i ZRRUM, për periudhën 2012-2014, në të cilin janë identifikuar disa synime strategjike, fokusi i të cilit është rritja e cilësisë së ofrimit të shërbimeve dhe Përbushja e standardeve minimale të shërbimit.

Unë mendoj se ky vit ka qenë një vit i ndryshimeve për ZRRUM, sidomos në ngritjen e kapaciteteve operacionale të ZRRUM, në lidhje me zbatimin e përgjegjësive të saja kryesore. Unë besoj se ne jemi në një pozitë të mirë për të përbushur sfidat e ardhshme të përcaktuara si prioritete në Planin Strategjik të ZRRUM për vitin 2012-2014.

Do doja të falënderoja dhe të shprehi mirënjohjen time për të gjithë stafin e zyrës dhe konsulencën, e cila është në mbështetje të ZRRUM përmes projektit (IPA) të financuar nga Zyra Ndërlidhëse e Komisionit Evropian (ECLO), për punën dhe angazhimin e tyre në përbushjen e përgjegjësive të tyre gjatë këtij viti.

Raif Preteni
Drejtore i ZRRUM

2. Statusi Ligjor dhe Përgjegjësitë e ZRRUM

2.1. AUTORIZIMET DHE PËRGJEGJËSITË E ZRRUM

Zyra Rregullatore për Ujësjellës dhe Mbeturina (ZRRUM) është organ i pavarur rregullator, i cili bënë licencimin dhe rregullimin ekonomik të ofruesve të shërbimeve të Ujësjellësit, Kanalizimit dhe Mbeturinave në Kosovë, i themeluar më 26 nëntor të vitit 2004 me [Rregulloren e UNMIK-ut 2004/49](#) në pajtim me Kornizën Kushtetuese të Kosovës. Rregullorja 2004/49 është amendamentuar me [Ligjin Nr. 03/L-086](#) të aprovuar nga Kuvendi i Republikës së Kosovës më datë 13 qershor 2008, duke transferuar raportimin e ZRRUM, nga UNMIK-u tek Kuvendi i Kosovës.

ZRRUM është autoritet i pavarur, që ka përgjegjësi rregullimin e Ndërmarrjeve Publike që ofrojnë shërbimet e ujësjellësit, kanalizimit, mbledhjes së mbeturinave, dhe deponimit të mbeturinave.

Përgjegjësitë kryesore të ZRRUM janë:

- **Përcaktimi i tarifave** që balancojnë nevojat e konsumatorëve për çmime të përballueshme dhe ruajtjen e integritetit financiar të ofruesve të shërbimeve;
- **Dhënia e licencave** për ofruesit e shërbimeve të ujësjellësit, grumbullimit të mbeturinave dhe deponimit të mbeturinave;
- **Mbrojtja e interesave të konsumatorëve**, duke siguruar që ofruesit e shërbimeve nuk keqpërdorin pozitën e monopolit dhe duke siguruar që shërbimet ofrohen në pajtim me standardet adekuate dhe të përcaktuara të shërbimit;
- **Monitorimi dhe raportimi i performancës** së ofruesve të shërbimeve;
- **Përcaktimi i procedurave dhe kushteve për shqyçje** individuale dhe kolektive të konsumatorëve nga rrjeti i ujësjellësit;
- **Themelimi i Komisioneve Këshilluese të Konsumatorëve** dhe mbështetja e punës së tyre.

Pra, ZRRUM është përgjegjës për të siguruar se ndërmarrjet publike që ofrojnë shërbimet e ujësjellësit, kanalizimit dhe mbeturinave në Kosovë, iu ofrojnë konsumatorëve shërbime efikente dhe cilësore me çmim të përballueshëm.

Në përmbushjen e përgjegjësiave të veta rregullatore, ZRRUM udhëhiqet nga korniza ligjore që është përcaktuar me Ligjin Nr. 03/L-086, si dhe legjislacionin tjetër që ka të bëjë me sektorin e ujit dhe mbeturinave. Në mënyrë më të hollësishme korniza ligjore është përcaktuar me legjislacionin sekondar (14 Rregullave) të nxjerrë nga ZRRUM në Janar të vitit 2005 dhe të Amandamentuara kohë pas kohe, [edhe gjatë vitit 2011](#).

2.2. STRUKTURA ORGANIZATIVE E ZRRUM

Në përputhje me Ligjin Nr. 03/L-086, ZRRUM udhëhiqet nga Drejtori dhe Zv. Drejtori, si persona përgjegjës për funksionimin e Zyrës, si dhe për marrjen e vendimeve rregullatore. Emërohen nga Kuvendi i Republikës së Kosovës, me mandat 5 vjeçar.

Me qëllim të operimit më efikent, efektiv dhe me kohë, ZRRUM ka aprovuar strukturën organizative të organizimit, sipas të cilës departamentet e ZRRUM i përgjigjen direkt Drejtorit të ZRRUM-it.


ZRRUM për vitin 2011 ka propozuar domosdoshmërinë për rritjen e numrit të stafit, me qëllim të mbulimit sa më të mirë të përgjegjësiave të saj. Ky propozim është mbështetur me vendimin Nr. 03-

V-356 të datës 8 korrik 2010 nga Kuvendi i Kosovës, me rastin e aprovimit të raportit vjetor të punës së ZRRUM-it për vitin 2009. Tri pozitat e hijezuara në organogram janë ende vakante dhe presim të plotësohen , pasi të kryhen procedurat me MF.

ZRRUM përbëhet nga katër departamente, tri prej të cilave janë përgjegjëse për aktivitetet rregullatore dhe një departament ofron mbështetje për punën e Zyrës. Departamentet përgjegjëse për aktivitetin rregullator janë: [Departamenti i Tarifave dhe Financave Rregullatore](#), [Departamenti i Performancës dhe Departamenti për Ligj dhe Licenca](#), ndërsa përgjegjës për mbështetjen e veprimtarisë rregullatore të ZRRUM-it është [Departamenti për Administratë dhe Financa](#).

Struktura organizative e ZRRUM është dhënë në Figurën 1 në vijim:

Figura 1: Organogram i ZRRUM



Tri vendet e hijezuara janë të paplotësuara, edhe pse Kuvendi i Kosovës në vitin 2010 parimisht e ka aprovuar dhe ka rekomanduar që MEF, me Buxhetin e vitit 2011, të ketë parasysh këto tri pozita.

3. Aktivitetet Rregullatore të ZRRUM

3.1. LICENCIMI

Në pajtim me kornizën ligjore të përcaktuar me Ligjin Nr. 03/L-086 , ZRRUM, gjatë vitit raportues ka licencuar kompanitë publike që ofrojnë shërbimet e grumbullimit të mbeturinave.

Për informimin e juaj më të plotë, po i paraqesim Kompanitë e Ujësjellësit dhe Kanalizimit, Kompanitë për Furnizim të Ujit me Shumicë, Kompanitë e Licencuara për Shërbimin e Grumbullimit të Mbeturinave, dhe Kompaninë e licencuara për Shërbimet e Deponimit të Mbeturinave.

(i) Kompanitë e Licencuara për Shërbimet e Ujësjellësit dhe Kanalizimit

Në pajtim me përgjegjësitë e përcaktuara me ligj dhe duke u bazuar në procedurat dhe rregullat e përcaktuara me legjislacionin sekondar, ZRRUM ka licencuar kompanitë regjionale të ujësjellësit dhe kanalizimit si vijon:

1. **KRU “Prishtina” Sh. A.**, që ofron shërbimet në komunat: Prishtinë, Fushë Kosovë, Obiliq, Podujevë, Lipjan, Shtime dhe Drenas ;
2. **KRU “Hidroregjioni Jugor” Sh.A.**, që ofron shërbimet në komunat: Prizren, Malishevë, Suharekë, Dragash dhe Mamush;
3. **KRU “Hidrodrini” Sh.A.**, që ofron shërbimet në komunat: Pejë, Istog, Klinë, Junik dhe komuna e Deçanit¹;
4. **KRU “Mitrovica” Sh.A.**, që ofron shërbimet në komunat: Mitrovicë, Skenderaj dhe Vushtrri;
5. **KRU “Hidro-sistemi Radoniqi” Sh.A.**, që ofron shërbimet në komunat: Gjakovë, Rahovec dhe Prizren;
6. **KRU “Hidromorava” Sh.A.**, që ofron shërbimet në komunat: Gjilan, Kamenicë dhe Viti;
7. **KRU “Bifurkacioni” Sh.A.**, që ofron shërbimet në komunat: Ferizaj dhe Kaçanik².

Ndërmarrjet publike të ujësjellësit dhe kanalizimit që kanë ekzistuar në komunat me popullatë shumicë serbe (Shtërpçë, Novobërdë, Mitrovicë e Veriut, Leposaviq, Zubin Potok dhe Zveçan) kanë mbetur jashtë proceseve të ristrukturimit dhe korporatizimit dhe rrjedhimisht kanë mbetur jashtë procesit rregullator që e zbaton ZRRUM.

Licencat e këtyre shtatë kompanive regjionale të ujësjellësit dhe kanalizimit janë në fuqi deri më 31 tetor 2012.

¹ Komuna e Deçanit ka qenë pjesë e zonës së shërbimit të KRU “Hidrodrini”, derisa me një vendim të Kuvendit Komunal i Deçanit të vitit 2007 ka vendosur të mos jetë pjesë e kompanisë regjionale “Hidrodrini” dhe ka themeluar ndërmarrjen komunale të ujësjellësit. Ky vendim i KK Deçan konsiderohet nga ZRRUM joligjor dhe është në kundërshtim me Ligjin për Ndërmarrjet Publike. Megjithatë situata e krijuar kërkon angazhimin e institucioneve kompetente qeveritare për abrogimin e vendimit të KK Deçan dhe kthimin e kësaj Kompanie nën autoritetin e KRU “Hidrodrini”.

² Komuna e Kaçanikut ka qenë pjesë e zonës së shërbimit të KRU “Bifurkacioni”,përderisa me një vendim të Kuvendit Komunal te Kaçanikut të vitit 2009 po ashtu ka vendosur të mos jetë pjesë e kompanisë rajonale “Bifurkacionit” dhe ka themeluar ndërmarrjen komunale të ujësjellësit. Ky vendim(nr.1461/09) i KK Kaçanikut, konsiderohet nga ZRRUM joligjor dhe është në kundërshtim me Ligjin për Ndërmarrjet Publike. Megjithatë situata e krijuar kërkon angazhimin e institucioneve kompetente qeveritare për abrogimin e vendimit të KK Kaçanikut dhe kthimin e kësaj Kompanie nën autoritetin e KRU “Bifurkacioni”.

Duke u bazuar në Ligjin nr. 03/L-086, dhe në Vendimin e Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr. 06/18, të datës 08.06.2011, me qëllim që Njësia Operative e Deçanit dhe Kaçanikut të kthehet në menaxhimin e KRU "Hidrodrini", respektivisht "Bifurkacioni", kemi pasur shumë tentativa me të dy komunat e lartpërmendura dhe një takim të përbashkët me Ministrin e Zhvillimit Ekonomik dhe Kryetarët e të dy komunave, me qëllim që këto dy njësi të kthehen nën menaxhimin e KRU-ve, nga të cilat janë ndarë në mënyrë të paligjshme.

Edhe përkundër kësaj, dy komunat e lartpërmendura nuk kanë shpreh vullnet për implementimin e Vendimit të Qeverisë, andaj ZRRUM, duke u bazuar në Ligjin 03/L-086 dhe Ligjin mbi NP Nr. 03/L-087, ka :

Filluar me Amandamentimin e dy (2) Licencave të Shërbimit (Licencën e Shërbimit të KRU "Hidrodrini" Sh.A. Pejë dhe KRU "Bifurkacioni" Sh.A. Ferizaj) dhe në afatin e paraparë ligjor deri më 02.01.2012, nëse nuk shfuqizohen vendimet e tyre, dy Komunat Deçan dhe Kaçanik nuk do të figurojnë në këto licenca të shërbimit, dhe rrjedhimisht në mënyrë të kundërligjshme do të operojnë pa licenca të shërbimit.

(ii) Kompania e Licencuar për Furnizim të Ujit me Shumicë

Furnizimi i ujit me shumicë me Rregulloren 2004/49 është përkufizuar si furnizimi i ujit të papërpunuar për ofruesit e shërbimeve të ujit dhe ujërave të zeza.

Kompania e vetme e licencuar që ofron ujë me shumicë është:

1. **"Ibër-Lepenci" Sh.A.** e cila furnizon ujë me shumicë për KRU "Mitrovica" Sh.A. dhe KRU "Prishtina" Sh.A.

Licenca e "Ibër –Lepencit" është valide deri më 31 tetor 2012.

(iii) Kompanitë e Licencuara për Shërbimin e Grumbullimit të Mbeturinave

1. **KRM "Pastrimi" Sh.A.** që ofron shërbimet për komunat: Prishtinë, Fushë Kosovë, Obiliq, Drenas, Lipjan, Podujevë dhe Graçanicë;
2. **KRM "Ekoregjioni" Sh.A.** që ofron shërbimet në komunat: Prizren, Suharekë, Malishevë, Rahovec, Mamush dhe Sharr;
3. **KRM "Ambienti" Sh.A.** që ofron shërbimet në komunat: Pejë, Istog, Klinë, Junik dhe Deçan³;
4. **KRM "Uniteti" Sh.A.** që ofron shërbimet e veta në komunat: Mitrovicë, Skenderaj dhe Vushtrri;
5. **KRM "Çabrati" Sh.A.** që ofron shërbimet në komunat: Gjakovë;
6. **KRM "Higjiena" Sh.A.** që ofron shërbimet në komunat: Gjilan, Kamenicë, Viti⁴, Novo Bërdo, Ranillug, Partesh dhe Klokot;
7. **KRM "Pastërtia" Sh.A.** që ofron shërbimet në komunat: Ferizaj, Shtime, Han i Elezit dhe Kaçanik.

Këtyre kompanive ju është vazhduar licenca më 01.12.2011 deri 30.11.2012.

³ Situata e njëjtë sikurse tek shërbimet e ujësjellësit dhe kanalizimit është edhe tek shërbimet e grumbullimit të mbeturinave sa i përket komunës së Deçanit.

⁴ Kuvendi Komunal i Vitisë ka marrë po ashtu vendim (në vitin 2011) që të jetë prapë nën menaxhimin KRM "Higjiena" d.

iv) Kompania e licencuar për Shërbimet e Deponimit të Mbeturinave

1. Kompania për Menaxhimin e Deponive në Kosovë-KMDK, që menaxhon deponitë: në Prishtinë, Podujevë, Gjiilan, Prizren dhe Stacionin e Transferit në Ferizaj. Vlefshmëria e licencës 01.10.2007-30.09.2012.

(v) Kompanitë e pa licencuara për menaxhimin me Deponitë


1. KRM "Ambienti" 5sh.a. menaxhon me Deponinë Regjionale të Pejës,
2. KRM "Uniteti" 6sh.a menaxhon me Deponinë Regjionale të Mitrovicës,
3. KRM "Ekoregjioni" 7sh.a menaxhon me Deponinë e Dragashit.

Në vijim, janë paraqitur zonat e shërbimit të kompanive regjionale të ujit (Figura 1) dhe të kompanive të mbeturinave (Figura 2).

⁵ **KRM "Ambienti"** ka qene e licencuar vetëm një here nga ZRRUM gjate periudhës 2007-2008aktualisht nuk është e licencuar për te menaxhuar me Deponin "Sverk"


Ngjajeshem është edhe me KRM "Uniteti për deponin ne "Germova"
Deponia ne Dragash nuk ka qene asnjehere e licencuar nga ZRRUM.

Figura 1: Zonat e Shërbimeve të Kompanive të Ujësjellësit dhe Kanalizimit



KUR Prishtina	KUR Hidroregjioni Jugor	KUR Hidrodrini	KUR Mitrovica	KRU Radoniqi	KRUK Bifurkacioni	KRUK Hidromorava	Komunat jashtë shërbimeve nga KUR-të
-Prishtina -Podujeva -Fushë Kosova -Obiliçi -Lipjani -Drenasi -Shtime	-Prizreni -Suhareka -Malisheva -Dragashi	-Peja -Klina -Istogu -Juniku -Deqani	-Mitrovica -Skenderaj -Vushtria	-Gjakova -Rahoveci	-Ferizaj -Kaçaniku	-Gjilani -Kamenica -Vitia	-Novoberda -Zubin Potoku -Leposaviqi -Shtërpca -Zveçani -Hani i Elezit

Figura 2: Zonat e Shërbimeve të Kompanive të Grumbullimit të Mbeturinave



KRM Pastrimi	KRM Ekoregjioni	KRM Ambienti	KRM Uniteti	KRM Çabрати	KRM Pastërtia	KRM Higjiena	Komunat jashtë shërbimeve nga KRM-të
-Prishtina -Podujeva -Fushë Kosova -Obiliçi -Lipjani -Drenasi -Graçanica	-Prizreni -Suhareka -Malisheva -Dragashi -Rahoveci -Mamusha	-Peja -Klina -Istogu -Deqani -Juniku	-Mitrovica -Skenderaj -Vushtrria	-Gjakova	-Ferizaj -Shtimja -Kaçaniku -Hani i Elezit	-Gjilani -Kamenica -Vitia -Novoberda -Ranillugu -Kilokoti -Parteshi	-Zubin Potoku -Leposaviqi -Shtërpca

3.2. MONITORIMI I PERFORMANSËS

ZRRUM monitoron performancën e kompanive publike të licencuara të cilat ofrojnë shërbimet e ujit dhe mbeturinave. Monitorimi i performancës bëhet në bazë të raporteve të cilat i dorëzojnë këto ndërmarrje tek ZRRUM, duke u bazuar në sistemin e raportimit të krijuar nga ZRRUM i quajtur OFCR/ROFK.

3.2.1. Performanca e Sektorit të Ujësjellësit dhe Mbeturinave.

Në vazhdim të këtij raporti është dhënë një përshkrim i shkurtër i performancës së përgjithshme të sektorit të shërbimeve të ujësjellësit dhe të mbeturinave, si dhe performanca individuale e kompanive publike, të cilat ofrojnë shërbimet e ujësjellësit-kanalizimit dhe shërbimet e grumbullimit të mbeturinave, si dhe kompanisë e cila menaxhon me Deponitë e Kosovës dhe ka për qëllim të informimit të opinionit me performancën e vitit 2011 në krahasim me atë të vitit 2010.

Ky raport i performancës është bazuar në të dhënat e ofruara çdo muaj nga kompanitë, në pajtim me obligimet e tyre raportuese që kanë ndaj ZRRUM-it.

Të dhënat e shfrytëzuara në këtë raport për vitin 2010, janë të audituara dhe si të tilla mund të konsiderohen të besueshme, çfarë nuk është rasti me të dhënat e vitit 2011 të cilat do të auditohen/verifikohen në muajin prill të këtij viti.

Performanca e Përgjithshme e Sektorit të Ujësjellësit dhe Kanalizimit

Ky kapitull paraqet një pasqyrë të performancës së përgjithshme të sektorit të Shërbimeve të ujit dhe të kanalizimit në Kosovë, për periudhën raportuese 2010/11. Treguesit e theksuar në këtë raport paraqesin Treguesit Kyç të Performancës (TKP), së sektorit dhe janë bazuar në nivelet e shërbimeve minimale. Njëherit janë paraqitur për të siguruar lexuesit me një pamje të gjerë të punës së ofruesve të këtyre shërbimeve. (TKP) përfshijnë aspektet operative, financiare dhe të shërbimeve ndaj konsumatorëve, të cilat më së miri pasqyrojnë gjendjen, si dhe janë të rëndësishëm dhe janë në mundësinë e Menaxhmentit për të ndikuar në përmirësimin e tyre.

Tabela 1. Performanca e përgjithshme e sektorit të shërbimeve të ujësjellësit

Treguesit	2010	2011	prog/reg
Prodhimi i ujit (m3/kons/m)	48	48	Trend i njëjtë
Shitja e ujit (m3/kons/m)	19	19	Trend i njëjtë
Konsumi i matur (%)	85%	88%	Trend pozitiv
Uji i pa-faturuar (%)	60%	61%	Trend negativ
Proporcioni i konsumatorëve me ujëmatës (%)	82%	81%	Trend negativ
Shkalla e arkëtimit (%)	66%	69%	Trend pozitiv
Norma e mbulimit të punës	1.05	1.06	Trend pozitiv
Kostoja për njësi (€/m3)	0.09	0.09	Trend i njëjtë
Efikasiteti i stafit ('000 kons)	6.6	6.4	Trend pozitiv
Ankesat për '000 kons	51.6	56.5	Trend negativ
Testet e dështuara të kualitetit të ujit (%)	3.7%	3.5%	Trend pozitiv

Në vitin 2011 sektori i shërbimeve të ujësjellësit ka shënuar progres në disa prej TKP, krahasuar me vitin 2010, sidomos evidente është progresi i vazhdueshëm në shkallën e arkëtimit ku është shënuar një përmirësim prej 3%, edhe pse jo me një përqindje të dëshiruar.

Shërbimet e furnizimit me ujë dhe kanalizim, të ofruar nga kompanitë publike të rregulluara nga ZRRUM, paraqesin ofruesin kryesor të këtyre shërbimeve në Kosovë, megjithatë ekziston edhe një numër i konsiderueshëm i popullatës e cila merë shërbime përmes skemave të veçanta të

ujësjellësve rural, të cilat menaxhohen prej vetë komunitetit. Aktualisht numri i popullatës së shërbyer nga KRU është rreth 1.375.000 apo rreth 70%, të cilët marrin shërbimin e ujësjellësit, përderisa vetëm 50% marrin shërbime të kanalizimit në raport me totalin e popullatës së Kosovës.

Prodhimi i ujit, Në total sasia e ujit të prodhuar nga të gjitha KRU për vitin 2011, është mbi 145,219,893 m³ dhe është më lartë se në vitin 2010 për 5%, kjo është arsyetuar me përmirësimin e orëve të furnizimit dhe rritjes së konsumatorëve të shërbyer.

Uji i pa faturuar (UPF), UPF është një masë e ujit të humbur në sistemin e shpërndarjes. Kjo është diferenca midis sasisë së ujit të prodhuar dhe të shpërndarë në rrjet dhe sasia e ujit të faturuar. UPF përbëhet nga humbjet teknike (rrjedhjeve) dhe humbjeve komerciale (lidhjet e paligjshme, konsum i pa faturuar dhe humbje të pa-njehsuara).

Tek Uji i Pa faturuar (UPF), ende nuk kemi një angazhim të duhur nga menaxhmenti i kompanive në përmirësimin e këtij treguesi shumë të rëndësishëm, i cili së bashku me Shkallën e Arkëtimit, paraqesin dy treguesit të cilët më së shumti ndikojnë në qëndrueshmërinë e tyre financiare dhe operative.

Për shtatë kompanitë rajonale të ujit në Kosovë, (UPF) në 2011 është 61%, që është 1% më i lartë se sa 2010, dhe kjo është në nivel shumë të lartë në krahasim me një nivel të pranueshëm ndërkombëtar prej 25%.

Për të vlerësuar madhësinë e problemit, më së miri është nëse humbjet e ujit i kthejmë në vlerë sasiore, nga 145 mil m³ të ujit të prodhuara, rreth 88 milion është UPF dhe ky fakt duhet të shërbejë si një nxitje për KRU, të dalë me një strategji për reduktimin e sajë.

Konsumi i Matur, paraqet sasinë e ujit të faturuar i cili është matur përmes ujëmatësve në raporte me totalin e ujit të faturuar për konsumatorët, matja e ujit të konsumuar është faktor i rëndësishëm meqenëse konsumatorët ngarkohen në bazë të konsumit të tyre reale dhe po ashtu ky është një mjet i rëndësishëm për kontrollimin e UPF. Në 2011 në raport me vitin 2010, ka pasur një përmirësim të vogël (1%) edhe pse ZRRUM ka insistuar që KRU të vendosin ujëmatësit për të gjithë konsumatorët brenda një afati ligjor.

Efiçenca e arkëtimit, prej 69% në 2011, do të thotë një rritje prej 3% krahasuar me 2010 shikuar në kategoritë e konsumatorëve vërehet se një rritje më e mirë është tek kategoria e konsumatorëve të Amvisërisë me 4%, tek Bizneset trendi është i njëjtë, përderisa tek konsumatorët institucional është një rritje prej 2%. në përgjithësi tek të gjitha KRU, gjatë kësaj periudhe raportuese kemi rritje të shkallës së arkëtimit në raport me faturimin.

Kostoja e operimit, Edhe në vitin 2011, shpenzimet operative për prodhimin dhe distribuimin e 1m³ ujë deri tek konsumatorët ka mbetur i njëjtë me (0,09€/m³). Kostoja e personelit e cila përfshinë fuqinë punëtore, është një nga komponenti më e lartë e shpenzimeve me 43%, nga totali duke u pasuar nga kategoria e shpenzimeve të energjisë elektrike dhe derivateve. Kontrolla e koston është shumë kritike në ofrimin e shërbimeve, së këndejmi shpenzimet e mëdha operative (pagat, kemikalet, energjia, mirëmbajtja dhe shpenzimet administrative), kanë ndikim në efikasitetin operativ të ndërmarrjes. Këto janë analizuar në mënyrë të gjithanshme nga ZRRUM, gjatë procesit tarifar në mënyrë për të parandaluar shpenzimet e pajustificuara, për kategori të caktuara. Reduktimi i kostove të tilla si shpenzimet e kemikaleve nuk mund të jetë domosdoshmërisht e dëshirueshme pasi kjo mund të ndikojë në cilësinë e ujit.

Norma e Mbulimit të Punës, në 2011 është 1.06 dhe është për 0.02, pikë më i lartë sesa në 2010. Të ardhurat nga paratë e gatshme kanë qenë pak mbi nivelin e mbulimit të shpenzimeve operative pa amortizim dhe kjo vjen si rezultat i ngritjes së shkallës së arkëtimit.

Efikasiteti i stafit, paraqet numrin e nevojshëm të stafit për të ju shërbyer 1000 konsumatorëve, edhe përkundër rritjes së numrit të punëtorëve në tërë sektorin nga 1,611 nga viti 2010 në 1,1640 për vitin 2011, apo shprehur në shkallë (2%), trendi i sektorit në tërësi është në drejtim të një efikasiteti më të madh të stafit, krahasuar me 2010, efikasiteti i stafit është rritur në 2011 nga 6.64 në 6.48, që është rritje prej 3%. Kjo është për shkakun e rritjes së bazës së konsumatorëve.

Ankesat e konsumatorëve, Është e qartë se cilësia e shërbimeve në sektorin e ujësjellësit dhe të kanalizimit është ende nën standardin e pritshëm, e që dëshmohej nga numri i ankesave nga publiku. Konsumatorët kanë të drejtë të ankohen kur ata nuk marrin shërbim të garantuar nga ofruesi. Në vitin 2011 mesatarisht për tërë sektorin ankesat e shërbimit për 1,000 konsumatorë ishin 60 sosh. Numri i ankesave të regjistruara në vitin 2011 është 14310, përfshirë shërbimet e ujit dhe të kanalizimit të drejtuar në KRU. Ky numër është më i lartë për 9%, se sa në vitin 2010, prej tyre mbi 10525, janë ankesa teknike (kryesisht për shkak të rrjedhjeve, ndërprerjeve të ujit, mos matjes së konsumit, defekteve teknike, përmbajtjeve të kanalizimit, etj) dhe 3,785 janë ankesa komerciale (kryesisht kanë të bëjnë me mënyrën e faturimit, gabimeve në faturim, etj), në përgjithësi një rritje e numrit të ankesave mund të tregojë përkeqësimin në shërbim dhe / ose që konsumatorët po rrisin besimin në ofruesit të cilët po merren me ankesat e tyre.

Cilësia e ujit, Cilësia e ujit është shumë e rëndësishme për shkak të ndikimit në shëndet që ka në konsumatorët, në vitin 2011, në përgjithësi numri i testeve të kryera nga IKSHPK është 12,305 prej të cilave 429 nuk kanë qenë në përputhje me standardet e përcaktuara. Në shkallë vendi dështimi i testeve për të dy llojet e parametrave, (Bakteriologjike dhe Fiziko-Kimik), është në nivelin prej 3.5%.

Kryesisht gjatë vitit ka pasur dështime bakteriologjike të cilat kanë qenë më të theksuara në tri KRU (Hidrodrini, Hidroregjioni Jugor dhe Mitrovica). ZRRUM këtë çështje e ka adresuar tek KRU dhe IKSHPK, dhe së bashku, janë ndërmarrë veprime për të përmirësuar situatën. Brengosëse mbetet situata në Komunën e Klinës, e cila në vazhdimësi është duke u furnizuar me ujë jo kualitativ.

Arritjet e sektorit në 2011, mundë të përmbledhen si në vijim:

- Rritja e konsumit të matur,
- Rritje e efikasitetit në arkëtimin e faturave,
- Rritja e mbulimit të kostove të operimit dhe mirëmbajtjes nga të ardhurat e përgjithshme,
- Ngritje të efikasitetit të stafit si dhe
- Përmirësim në kualitetin e ujit.

Shqetësimet e sektorit mund të përmbledhen në çështjet në vijim:

- Niveli i lartë i Ujit të Pa Faturuar (UPF),
- Nivel i ultë i proporcionit të konsumatorëve të cilët faturohen sipas leximit të ujëmatësit,
- Ankesat e konsumatorëve janë vazhdimisht në rritje.

3.2.2. Performanca Individuale e Kompanive Rajonale të Ujësjellësit

Performanca relative tregon krahasimin e performancës së secilës kompani individuale të ujit në mes të viteve, në këtë rast në mes të vitit 2011 dhe 2010.

Më poshtë janë paraqitur trendet e zhvillimit për secilën kompani të ujit.

KRU 'Prishtina', sh.a.

Tabela 2. Performanca relative e KRU 'Prishtina', sh.a.

Treguesit	2010	2011	prog/reg
Prodhimi i ujit (m3/kons/m)	41	40	Trend negativ
Shitja e ujit (m3/kons/m)	19	18	Trend negativ
Konsumi i matur (%)	90%	93%	Trend pozitiv
Uji i pa-faturuar (%)	55%	54%	Trend pozitiv
Proporcioni i konsumatorëve me ujëmatës (%)	83%	84%	Trend pozitiv
Shkalla e arkëtimin (%)	70%	70%	Trend i njëjtë
Norma e mbulimit të punës	1.21	1.13	Trend negativ
Kostoja për njësi (€/m3)	0.10	0.11	Trend negativ
Efikasiteti i stafit ('000 kons)	5.74	5.62	Trend pozitiv
Ankesat për '000 kons	58.0	62.61	Trend negativ
Testet e dështuara të kualitetit të ujit (%)	0.8%	1.9%	Trend negativ

Edhe në vitin 2011, krahasuar me vitin 2010, kjo kompani nuk ka treguar ndonjë progres të rëndësishëm në performancën e saj.

Uji i pa faturuar ka shënuar rrënje nga 55% sa ishte në vitin 2010 në 54% për 2011, i cili vjen si rezultat i një faturimi më të mirë gjatë këtij viti. Megjithatë gjendja mbetet mjaft shqetësuese në këtë tregues nga shkaku i nivelit të lartë të humbjeve teknike ashtu edhe atyre komerciale.

Konsumi i matur gjatë vitit 2011 ka shënuar ngritje për 3% krahasuar me vitin 2010, i cili vije nga shkaku i leximit me të rregullt të ujëmatësve, si dhe pajisjes së konsumatorëve me ujëmatës.

Shkalla e arkëtimit nuk ka pas ndonjë ndryshim, ka mbet në nivelin e njëjtë me 70%, sa ishte edhe në vitin paraprak. KRU ‘Prishtina’, ka pasur një arkëtim më të ulët tek kategoria e konsumatorëve të bizneseve dhe institucioneve.

Numri i ankesave në total gjatë vitit 2011, krahasuar me 2010 është rritur për 12%, duke rezultuar me rritje të pakënaqësisë, sidomos konsumatorët kanë shprehur ankesat e tyre në lidhje me mënyrën e faturimit të konsumatorëve të cilët jetojnë në banesa kolektive, ku faturimi për konsumin e ujit është bërë sipas ujëmatësit të përbashkët. Kjo mënyrë e faturimit sipas ndarjes së Konsumit proporcionalisht sipas njësive banesore, nga KRU ‘Prishtina’ është korrigjuar në gjysmën e dytë të vitit 2011.

KRU ‘Hidroregjioni Jugor’ sh.a.

Tabela 3. Performanca relative e KRU ‘Hidroregjioni Jugor’, sh.a.

Treguesit	2010	2011	prog/reg
Prodhimi i ujit (m3/kons/m)	41	49	Trend pozitiv
Shitja e ujit (m3/kons/m)	17	18	Trend pozitiv
Konsumi i matur (%)	89%	92%	Trend pozitiv
Uji i pa-faturuar (%)	58%	63%	Trend negativ
Proporcioni i konsumatorëve me ujëmatës (%)	81%	82%	Trend pozitiv
Shkalla e arkëtimit (%)	69%	72%	Trend pozitiv
Norma e mbulimit të punës	0.95	1.05	Trend pozitiv
Kostoja për njësi (€/m3)	0.12	0.11	Trend pozitiv
Efikasiteti i stafit ('000 kons)	6.73	6.54	Trend pozitiv
Ankesat për '000 kons	14.8	37.83	Trend negativ
Testet e dështuara të kualitetit të ujit (%)	9.0%	5.3%	Trend pozitiv

Në vitin 2011, krahasuar me 2010 kjo kompani ka treguar performancë më të mirë në shumicën e treguesve kyç të performancës.

Gjatë vitit 2011, uji i pa faturuar (UPF) është rritur në 63% nga 58%, sa ishte në vitin 2010 si rezultat i rritjes së prodhimit të ujit, mbi 4 milion m3, janë prodhuar më tepër në vitin 2011 krahasuar me 2010, përderisa tek faturimi nuk ka pas ndonjë përmirësim të madh. Ky nivel i lartë i UPF nuk mund të arsyetohen edhe për shkak se KRU ‘Hidroregjioni Jugor’ gjatë vitit të kaluar ka pasur reduktime të mëdha të ujit.

Përmirësim prej 3%, është shënuar tek shkalla e arkëtimit gjatë vitit 2011, krahasuar me vitin 2010, ngritje e efikasitetit në arkëtim është arritur në tri kategoritë e konsumatorëve. Kjo ka ndikuar tek, Norma e mbulesës së punës, duke mundësuar që KRU ‘Hidroregjioni Jugor’ të mbulojë shpenzimet e saja operative me të ardhurat e realizuara.

Kualiteti i ujit të furnizuar aktualisht është në nivelin e papranueshëm me 5.3%, edhe pse është shënuar progres, në zvogëlimin e mostrave, të cilat nuk janë në përputhje me standardet e kërkuar prej 9%, sa ishte 2010.

KRU 'Hidrodrini' sh.a.

Tabela 4. Performanca e KRU 'HIDRODRINI', sh.a.

Treguesit	2010	2011	prog/reg
Prodhi i ujit (m3/kons/m)	72	68	Trend negativ
Shitja e ujit (m3/kons/m)	20	20	Trend i njëjtë
Konsumi i matur (%)	93%	93%	Trend i njëjtë
Uji i pa-faturuar (%)	72%	70%	Trend pozitiv
Proporcioni i konsumatorëve me ujëmatës (%)	87%	86%	Trend negativ
Shkalla e arkëtimit (%)	59%	62%	Trend pozitiv
Norma e mbulimit të punës	1.09	1.12	Trend pozitiv
Kostoja për njësi (€/m3)	0.05	0.05	Trend i njëjtë
Efikasiteti i stafit ('000 kons)	5.39	5.29	Trend pozitiv
Ankesat për '000 kons	78.6	81.24	Trend pozitiv
Testet e dështuara të kualitetit të ujit (%)	8.4%	7.8%	Trend pozitiv

Në vitin 2011 krahasuar me 2010 'Hidrodrini', sh.a. ka treguar performancë më të mirë në disa prej treguesve kyç, përderisa tek vetëm dy tregues trendet kanë qenë negative.

Uji i pa-faturuar ka shënuar progres për 2% krahasuar me 2010, kryesisht për faktin se KRU "Hidrodrini" ka pasur zvogëlim të sasisë së ujit të prodhuar në vitin 2011, por njëkohësisht ka rritur sasinë e ujit të faturuar, megjithatë niveli prej 70%, i UPF, nuk është i arsyeshëm edhe për faktin se këtë vit edhe në këtë kompani janë ndier pasojat e thatësisë e cila ka mbretëruar në vendin tonë.

Shkalla e arkëtimit është rritur për 3%, progres është shënuar kryesisht tek kategoria e konsumatorëve shtëpiak, përderisa gjendja me pagesat e faturave ndaj kompanisë është më e keqe te konsumatorët e Bizneseve dhe Institucioneve.

Numri i ankesave në total, gjatë vitit 2011, krahasuar me 2010 është rritur për 6%, një rritje e pakënaqësisë së konsumatorëve, kryesisht është në aspektin teknik- operative të shërbimit të cilin e ofron kjo kompani e cila ilustron me faktin se 96% e ankesave kanë qenë të kësaj natyre.

KRU 'Mitrovica' sh.a.

Tabela 5. Performanca e KRU 'MITROVICA', sh.a.

Treguesit	2010	2011	prog/reg
Prodhi i ujit (m3/kons/m)	69	60	Trend negativ
Shitja e ujit (m3/kons/m)	32	29	Trend negativ
Konsumi i matur (%)	70%	72%	Trend pozitiv
Uji i pa-faturuar (%)	53%	52%	Trend pozitiv
Proporcioni i konsumatorëve me ujëmatës (%)	56%	51%	Trend negativ
Shkalla e arkëtimit (%)	54%	57%	Trend pozitiv
Norma e mbulimit të punës	0.66	0.67	Trend pozitiv
Kostoja për njësi (€/m3)	0.10	0.10	Trend i njëjtë
Efikasiteti i stafit ('000 kons)	10.29	9.04	Trend pozitiv
Ankesat për '000 kons	-	-	-
Testet e dështuara të kualitetit të ujit (%)	2.4%	4.3%	Trend negativ

Në vitin 2011 krahasuar me 2010, KRU 'Mitrovica', sh.a., ka treguar performancë pothuajse të barabartë për sa i përket progresit dhe regresit në treguesit kyç.

Në UPF, KRU 'Mitrovica' ka shënuar përmirësim prej 1%, e cila kryesisht lidhet me zvogëlimin e ujit të prodhuar si dhe rritjen në efikasitetin e faturimit të ujit të konsumuar.

Shkalla e arkëtimit gjatë vitit 2011 ka shënuar progres për 3%, krahasuar me vitin 2010, përderisa faturimi pothuajse ka mbet në pozitën e njëjtë me një ndryshim shumë të vogël në përmirësim. Megjithatë, norma e mbulesës së punës prej 0.67, e cila edhe pse në progres të vogël prej 0.01, krahasuar me vitin paraprak tregon se kompania qëndron dobët financiarisht dhe nuk është në gjendje t'i mbulojë shpenzimet operative nga të hyrat vetanake.

Kualitetin e ujit të pijes gjatë vitit 2011, në krahasim me 2010 i cili është furnizuar nga KRU 'Mitrovica' është përkeqësuar, sidomos dështimet kanë qenë në Njësitë Operative të Vushtrrisë dhe Skenderajt. Shqetësimet në lidhje me këtë çështje janë adresuar tek kjo kompani nga ana e ZRRUM.

KRU 'Radoniqi', sh.a.

Tabela 6. Performanca relative e KRU 'HS Radoniqi', sh.a.

Treguesit	2010	2011	prog/reg
Prodhimi i ujit (m ³ /kons/m)	52	60	Trend pozitiv
Shitja e ujit (m ³ /kons/m)	20	18	Trend negativ
Konsumi i matur (%)	80%	90%	Trend pozitiv
Uji i pa-faturuar (%)	61%	70%	Trend negativ
Proporcioni i konsumatorëve me ujëmatës (%)	92%	91%	Trend negativ
Shkalla e arkëtimit (%)	67%	71%	Trend pozitiv
Norma e mbulimit të punës	0.93	1.04	Trend pozitiv
Kostoja për njësi (€/m ³)	0.10	0.09	Trend pozitiv
Efikasiteti i stafit ('000 kons)	7.82	7.81	Trend pozitiv
Ankesat për '000 kons	45.5	37.50	Trend pozitiv
Testet e dështuara të kualitetit të ujit (%)	0.7%	0.1%	Trend pozitiv

Në vitin 2011 krahasuar me 2010 KRU 'Radoniqi', sh.a., ka shënuar performancë më të mirë në shumicën e treguesve kyç.

Uji i pa faturuar ka shënuar rritje nga 61% sa ishte në vitin 2010 në 70% për 2011. Si duket KRU "Radoniqi" ka rritur sasinë e prodhimit të ujit, përderisa faturimi i ujit të distribuar në rrjet ose ka humbur përmes rrjedhjeve apo është keqpërdorur. Kjo ka ndikuar që UPF, në këtë kompani të shënoj vlera rekorde.

Konsumi i matur ka shënuar progres gjatë kësaj periudhe raportuese, e nga 80% sa ishte në vitin 2010 në 90% në 2011, tek kjo ka ndikuar faturimi total i sasisë së ujit i cili krahasuar me vitin paraprak është zvogëluar, ndërsa faturimi përmes ujëmatësve të konsumatorëve është rritur.

KRU "Radoniqi" ka arritur që në vitin 2011, të rris Shkalla e arkëtimit për 4%, sidomos rritje e shkallë së arkëtimit ka ndodhur tek konsumatore shtëpiak dhe ato të bizneseve. Niveli në shkallën e arkëtimit prej 71%, krahas zvogëlimit të shpenzimeve operative ka mundësuar një rritje të normës së mbulesës së punës.

Kualitetit të ujit të pijshëm i furnizuar nga kjo Kompani, është në nivelin më të mirë më vetëm 0.1% e testeve të realizuar nga IKSHPK, nuk janë në përputhje me standardet e kualitetit të ujit.

KRU 'Bifurkacioni' sh.a.

Tabela 7. Performanca e KRU 'BIFURKACIONI', sh.a.

Treguesit	2010	2011	prog/reg
Prodhi i ujit (m3/kons/m)	30	29	Trend negativ
Shitja e ujit (m3/kons/m)	12	12	Trend i njëjtë
Konsumi i matur (%)	67%	67%	Trend njëjtë
Uji i pa-faturuar (%)	61%	59%	Trend pozitiv
Proporcioni i konsumatorëve me ujëmatës (%)	70%	72%	Trend pozitiv
Shkalla e arkëtimit (%)	61%	63%	Trend pozitiv
Norma e mbulimit të punës	1.18	1.09	Trend negativ
Kostoja për njësi (€/m3)	0.09	0.10	Trend negativ
Efikasiteti i stafit ('000 kons)	6.04	6.10	Trend negativ
Ankesat për '000 kons	9.7	11.17	Trend negativ
Testet e dështuara të kualitetit të ujit (%)	7.1%	3.6%	Trend pozitiv

Gjatë vitit 2011 krahasuar me vitin 2010, KRU 'Bifurkacioni', sh.a. ka treguar performancë pothuajse të barabartë në treguesit kyç të performancës.

Në vitin 2011 krahasuar me 2010, UPF ka shënuar rënie për 2%, si rezultat i rritjes së njëtrajtshme të prodhimit dhe sasisë së ujit të faturuar.

Gjatë vitit 2011 krahasuar me vitin 2010 shkalla e arkëtimit është rritur për 2%, kjo ka ndodhur për shkak të arkëtimit më të lartë në dy kategoritë e konsumatorëve, ata shtëpiak dhe institucional. Ankesat gjatë vitit 2011, krahasuar me vitin 2010, janë rritur për 19%, duke reflektuar pakënaqësinë e konsumatorëve, në veçanti me aspektet teknike, ku 83% e ankesave të parashtruara gjatë vitit 2011, janë të kësaj natyre.

Është shënuar po ashtu përmirësimi i dukshëm i kualitetit të ujit nga 7.1%, sa ishin dështimet në vitin 2010 në 3.6% në vitin 2011, edhe pse këtu vlen të theksohet se në përqindjen e dështimeve kanë ndikuar ujësjellësit rural në disa fshatra të cilat menaxhohen nga kjo kompani.

KRU 'Hidromorava' sh.a.

Tabela 8. Performanca relative e KRU 'Hidromorava', sh.a.

Treguesit	2010	2011	prog/reg
Prodhi i ujit (m3/kons/m)	34	32	Trend negativ
Shitja e ujit (m3/kons/m)	14	13	Trend negativ
Konsumi i matur (%)	80%	80%	Trend i njëjtë
Uji i pa-faturuar (%)	60%	59%	Trend pozitiv
Proporcioni i konsumatorëve me ujëmatës (%)	81%	81%	Trend i njëjtë
Shkalla e arkëtimit (%)	68%	78%	Trend pozitiv
Norma e mbulimit të punës	1.08	1.14	Trend pozitiv
Kostoja për njësi (€/m3)	0.08	0.09	Trend negativ
Efikasiteti i stafit ('000 kons)	7.91	7.87	Trend pozitiv
Ankesat për '000 kons	142.7	157.98	Trend negativ
Testet e dështuara të kualitetit të ujit (%)	1.3%	1.9%	Trend negativ

Në vitin 2011, krahasuar me vitin 2010, KRU 'Hidromorava', sh.a. ka treguar performancë të dobët në disa prej tregues kyç të performancës.

Gjatë vitit 2011 shkalla e arkëtimit ka shënuar ngritje në 78% krahasuar me vitin 2010 e cila ishte 68%. Në ngritjen e shkallës së arkëtimit ka ndikuar ndërmarrja e disa aktiviteteve të kësaj kompanie

për të ngritur eficiencën e arkëtimit, sidomos në këtë ka ndikuar marrëveshja e arritur në mes KRU “Hidromorava” dhe Komunës, për kushtëzimin e qytetarëve me pagesë të faturave për shërbimet e ujit.

Norma e mbulesës së punës gjatë vitit 2011, po ashtu është rritur në 1.14 nga 1.08, sa ishte në vitin 2010, kjo tregon se kompania është në gjendje t’i mbulojë shpenzimet operative nga të hyrat vetanake.

Numri i ankesave në total gjatë vitit 2011, krahasuar me 2010 ka vazhduar të rritet edhe tek kjo kompani ankesat e qytetarëve janë drejtuar tek aspektet operative të shërbimit.

3.2.3. Performanca e Përgjithshme e Sektorit të Grumbullimit të Mbeturinave

Vlerësimi i performancës së sektorit të mbeturinave është bërë përmes 5(pesë) Treguesve Kyç të Performancës (TKP).

Tabela 9. Performanca relative e KRM-ve

Treguesit	2010	2011	prog/reg
Shkalla e arkëtimit %	61%	59%	Trend negativ
Norma e mbulimit të punës	0.93	0.89	Trend negativ
Kostoja për njësi (€/t)	33.48	36.58	Trend negativ
Efikasiteti i stafit ('000 kons.)	9.63	8.94	Trend pozitiv
Ankesat për '000 kons.	10.37	14.27	Trend negativ

Performanca e Kompanive që shërbejnë në grumbullimin dhe transportimin e mbeturinave në 2011, nuk është në nivel të kënaqshëm, vetëm një tregues ka shënuar trende pozitive.

Eficienca e arkëtimit, është në nivel shumë të ulët me vetëm 59% të arkëtimit në raport me faturimin, brengosëse është tendenca e përkeqësimit të mëtutjeshëm e këtij treguesi.

Norma e mbulimit të punës, matë mbulimin e shpenzimeve operative si dhe tregon qëndrueshmërinë afat shkurtër financiare: (norma e të ardhurave operative kesh ndarë për shpenzimet operative pa amortizim (aktual)).

Norma e mbulimit të punës në 2011 është 0.89, dhe është 5% më e ultë se në vitin 2010, kjo d.th se sektori nuk ka qenë në gjendje t’i mbulojë shpenzimet operative me të hyrat e gatshme.

Shpenzimet operative për ton mbeturina të grumbulluara, në nivel të sektorit janë ngritur nga 33.48€ sa ishin në vitin 2010 në 36.58€ për vitin 2011.

Efikasiteti i stafit, është treguesi i vetëm i cili ka shënuar përmirësim, edhe pse niveli prej 8.94 punëtorëve të cilët ju shërbejnë 1000 konsumatorëve, sugjeron se ka ende jo efikasitet dhe numër të madh të punëtorëve në këto ndërmarrje.

3.2.4. Performanca Individuale e Kompanive Rajonale të Mbeturinave

KRM ‘Pastrimi’, sh.a.

Në vijim është paraqitur një pasqyrë e trendëve të zhvillimit për secilën kompani, në disa prej treguesve kyç të Performancës.

Tabela 10. Performanca relative e KRM 'Pastrimi' sh.a.

Treguesit	2010	2011	prog/reg
Shkalla e arkëtimit %	55%	51%	Trend negativ
Norma e mbulimit të punës	0.98	0.91	Trend negativ
Kostoja për njësi (€/t)	33.24	39.61	Trend negativ
Efikasiteti i stafit ('000 kons.)	8.70	8.79	Trend pozitiv
Ankesat për '000 kons.	22.65	34.62	Trend negativ

Në vitin 2011 krahasuar me 2010, KRM 'Pastrimi', në shumicën e treguesve kyç, ka shënuar trende negative.

Shkalla e arkëtimit, ka shënuar ulje për 4%, duke ndikuar që norma e mbulimit të punës të shënojë trende negative edhe në vitin 2011, kjo d.th se KRM "Pastrim" nuk ka qenë në gjendje t'i mbulojë shpenzimet operative me të hyrat e gatshme.

Shpenzimet operative për ton janë ngritur nga 33.24€ në 39.61€, si shkak i rritjes së shpenzimeve në pothuajse të gjitha kategoritë e shpenzimeve operative (Pagave, Derivateve).

KRM 'Ekoregjioni', sh.a.

Tabela 11. Performanca relative e KRM 'Ekoregjioni' sh.a.

Treguesit	2010	2011	prog/reg
Shkalla e arkëtimit %	56%	54%	Trend negativ
Norma e mbulimit të punës	0.83	0.82	Trend negativ
Kostoja për njësi (€/t)	32.76	29.92	Trend pozitiv
Efikasiteti i stafit ('000 kons.)	9.54	9.22	Trend pozitiv
Ankesat për '000 kons.	0.00	4.79	Trend negativ

Në Shkallën e arkëtimit kjo kompani ka treguar efikasitet më të dobët në vitin 2011 në raport me atë 2010. Ky trend negativ është duke vazhduar për disa vite me radhë.

Shpenzimet operative për ton mbeturina të grumbulluara kanë shënuar një rënie për 2.84€, si rezultat i rritjes së grumbullimit të mbeturinave, përkundër një ngritjeje të vogël të Shpenzimeve Operative.

Në vitin 2011 krahasuar me vitin 2010, KRM 'Ekoregjioni', ka treguar performancë më të dobët në treguesit shkalla e arkëtimit dhe ankesat e Konsumatorëve, ndërsa në treguesit tjerë performanca kanë qenë pozitive.

Norma e mbulimit të punës tregon se kjo kompani edhe në vitin 2011 nuk ka qenë në gjendje t'i mbulojë shpenzimet operative me të hyrat e gatshme

KRM 'Ambienti', sh.a.

Tabela 12. Performanca relative e KRM 'Ambienti' sh.a.

Treguesit	2010	2011	prog/reg
Shkalla e arkëtimit %	61%	66%	Trend pozitiv
Norma e mbulimit të punës	0.94	1.09	Trend pozitiv
Kostoja për njësi (€/t)	28.66	31.40	Trend negativ
Efikasiteti i stafit ('000 kons.)	7.15	8.32	Trend negativ
Ankesat për '000 kons.	5.83	2.01	Trend pozitiv

Në vitin 2011 krahasuar me 2010, KRM 'Ambienti' ka treguar performancë më të mirë në 3(tre) nga 5(pesë) treguesit kyç të performancës.

Sidomos shkalla e arkëtimit në vitin 2011 ka shënuar ngritje për 5%, duke ndikuar që edhe norma e mbulimit të punës të ketë përmirësim, pra norma e mbulimit të punës prej 1.09 tregon se kompania ka qenë financiarisht në gjendje t'i mbulojë të gjitha shpenzimet operative me të hyrat e arkëtuara.

Shpenzimet për një ton mbeturina të grumbulluara kanë trend negativ, prej 28.66 nga viti 2010 në 31.40 për 2011, si rezultat i rritjes së ndjeshme të shpenzimeve operative në kategorinë e pagave dhe derivateve.

KRM 'Ambienti' në vitin 2011, ka ngritur numrin e punëtorëve për 26, përkundër zvogëlimit të numrit të konsumatorëve, gjë që ka ndikuar që efikasiteti i stafit të ketë ulje për 14%.

KRM 'Uniteti', sh.a.

Tabela 13. Performanca relative e KRM 'Uniteti' sh.a.

Treguesit	2010	2011	prog/reg
Shkalla e arkëtimit %	60%	63%	Trend pozitiv
Norma e mbulimit të punës	0.81	0.69	Trend negativ
Kostoja për njësi (€/t)	28.66	27.73	Trend pozitiv
Efikasiteti i stafit ('000 kons.)	17.07	16.88	Trend pozitiv
Ankesat për '000 kons.	0	13.27	Trend negativ

Në vitin 2011 krahasuar me 2010, KRM 'Uniteti' ka treguar performancë më të mirë në tre TKP, duke përfshirë Shkallën e arkëtimit, e cila ka shënuar ngritje për 3%. Përkundër kësaj në vitin 2011 norma e mbulimit të punës ka shënuar trende negative prej 0.81 në 0.69 të ndikuar kryesisht nga rritja e shpenzimeve operative.

Shpenzimet operative për ton janë ulur nga 28.66€ në 27.73€, po ashtu, efikasiteti i stafit ka shënuar përmirësim nga 17.07 në 16.88, dhe kjo është për shkak të rritjes së numrit të konsumatorëve.

KRM 'Çabрати', sh.a.

Tabela 14. Performanca relative e KRM 'Çabрати' sh.a

Treguesit	2010	2011	prog/reg
Shkalla e arkëtimit %	61%	67%	Trend pozitiv
Norma e mbulimit të punës	0.91	0.86	Trend negativ
Kostoja për njësi (€/t)	36.04	54.34	Trend negativ
Efikasiteti i stafit ('000 kons.)	10.68	8.56	Trend pozitiv
Ankesat për '000 kons.	6.68	6.71	Trend negativ

Në vitin 2011 në raport me 2010, KRM 'Çabрати' ka treguar performancë më të mirë në shkallën e arkëtimit dhe tek treguesi i efikasitetit të stafit. Shkalla e arkëtimit është ngritur nga 61% sa ishte në vitin 2010 në 67% për vitin 2011.

Norma e mbulimit të Punës me vetëm 0.86, tregon se kjo kompani nuk ka qenë në gjendje t'i mbulojë shpenzimet e saja operative në vitin 2011, me të hyrat e saja të realizuara.

Shpenzimet operative për ton mbeturina të grumbulluara dhe të transportuara në deponi janë ngritur nga 36.04€ në 54.34€ gjatë kësaj periudhe raportuese, e kjo si rezultat i rritjes po thuajse të të gjitha kategorive të shpenzimeve operative. Në rritjen e shpenzimeve operative ka ndikuar pagesa e taksës së deponimit të mbeturinave, meqenëse kjo kompani në vitin 2011 ka arritur tërë totalin e mbeturinave të grumbulluara ti deponoj në deponinë e licencuar të Landovicës.

KRM 'Pastërtia', sh.a.

Tabela 15. Performanca e KRM 'PASTËRTIA' sh.a

Treguesit	2010	2011	prog/reg
Shkall a e arkëtimit %	79%	67%	Trend negativ
Norma e mbulimit të punës	1.15	0.95	Trend negativ
Kostoja për njësi (€/t)	46.55	48.49	Trend negativ
Efikasiteti i stafit ('000 kons.)	8.88	8.33	Trend pozitiv
Ankesat për '000 kons.	6.46	6.22	Trend negativ

Kjo kompani gjatë vitit 2011 krahasuar me vitin 2010, përveç efikasitetit të stafit në të gjithë treguesit e tjerë të analizuar ka shënuar trende negative.

Shkalla e arkëtimit ka shënuar rënie për 12%, në raport me vitin 2010, kjo sugjeron kompaninë për të analizuar shkaqet për një jo efikasitet të tillë.

Shpenzimet operative për ton janë ngritur nga 46.55€ në 48.49€, dhe kjo ka ndodh si rezultat i rritjes pothuajse të të gjitha kategorive të shpenzimeve operative.

Të efikasiteti i stafit kemi një përmirësim të lehtë nga 8.88 në 8.33, e cila është rezultat i rritjes së numrit të konsumatorëve edhe përkundër rritjes së numrit të punëtorëve.

KRM 'Higjiena', sh.a.

Tabela 16. Performanca relative e KRM 'Higjiena' sh.a.

Treguesit	2010	2011	prog/reg
Shkalla e arkëtimit %	71%	69%	Trend negativ
Norma e mbulimit të punës	0.90	0.92	Trend pozitiv
Kostoja për njësi (€/t)	46.17	41.65	Trend pozitiv
Efikasiteti i stafit ('000 kons.)	10.91	6.32	Trend pozitiv
Ankesat për '000 kons.	8.36	3.86	Trend pozitiv

Në vitin 2011 krahasuar me 2010, KRM 'Higjiena' sh.a., ka treguar trendë pozitive në katër tregues përdorues vetëm në shkallën e arkëtimit, trendet kanë qenë negative.

Shpenzimet operative për ton janë ulur nga 46.17€ në 41.65€, dhe kjo ka ndodh si rezultat i rritjes së efikasitetit të stafit në grumbullimin e mbeturinave për vitin 2011. Në raport me vitin 2010 janë grumbulluar më tepër mbeturina për rreth 6000 ton.

Norma e Mbulimit të Punës në nivelin 0.92, sugjeron se kjo kompani ende është nën nivelin e mbulimit të kostove operative me të hyra kesh.

3.2.5. Performanca e Kompanisë për Menaxhimin e Deponive të Mbeturinave në Kosovë (KMDK)

Në tabelën e mëposhtme janë paraqitur trendët e zhvillimit të Kompanisë për Menaxhimin e Deponive në Kosovë.

Tabela 17. Performanca relative e 'KMDK' sh.a.

Treguesit	2010	2011	prog/reg
Shkalla e arkëtimit %	57%	62%	Trend pozitiv
Norma e mbulimit të punës	0.86	0.87	Trend pozitiv
Kostoja për njësi (€/t)	3.53	3.76	Trend negativ

Në vitin 2011 në raport me vitin 2010, 'KMDK' sh.a, ka treguar performancë më të mirë në treguesit si shkalla e arkëtimit dhe norma e mbulimit të punës.

Gjatë vitit 2011 krahasuar me vitin 2010, shkalla e arkëtimit ka shënuar ngritje për 5%, kjo ka ndikuar në ngritjen minore të normës së mbulimit të punës prej 0.86 në 0.87. Kjo kompani ende nuk është në gjendje të qëndrueshme financiare për ti mbuluar shpenzimet operative me të hyrat e realizuara nga faturimi.

Shpenzimet operative, në këtë kompani vit pas viti janë duke shënuar rritje për një ton mbeturina të trajtuara. Në vitin 2011 shpenzohen 3.76€.

3.3. TARIFAT E SHËRBIMIT

Departamenti i Financave dhe Tarifave Rregullatore (DFTRR), si njësi organizative e ZRRUM-it gjatë vitit raportues 2011 ka kryer detyrat dhe punët e parapara me planin e vet të punës, i cili kryesisht ishte i ndërlidhur me përcaktimin e tarifave të shërbimit të ujësjellësit dhe kanalizimit për tri (3) vitet e ardhshme 2012-2014, dhe tarifave një (1) vjeçare për shërbimin e administrimit të mbeturinave të ngurta komunale. Në mënyrë specifike duhet përmendur;

- tarifat e shërbimeve të ujit për shtatë (7) kompani,
- një tarifë për NH "Ibër-Lepenc" sh. a. Prishtinë, e cila furnizon me ujë të pa trajtuar KRU "Mitrovica" sh. a. Mitrovicë dhe KRU "Prishtina" sh. a. Prishtinë për furnizim të Drenasit,
- tarifat e shërbimit për administrim me mbeturina të ngurta komunale për shtatë (7) kompani, dhe
- një (1) tarifë për shërbimin e menaxhimit të deponive sanitare

3.3.1. Përcaktimi i tarifave të shërbimit të ujit dhe të mbeturinave

3.3.1.1. Përcaktimi i tarifave të shërbimit të ujit për vitet 2012-2014

Gjatë vitit kalendarik 2011 për tarifat e shërbimit të ujit për herë të dytë janë përcaktuar tarifafatmesme tre (3) vjeçare 2012-2014, pas tarifave të para të përcaktuara gjatë viteve 2009-2011. Për këtë proces rregullatorë, janë bërë përgatitjet paraprake të gjata, për të realizuar dhe ekzekutuar këtë proces tarifar. Realizimin e këtij procesi e ka ndihmuar ekipi i konsulentëve ndërkombëtarë i cili është duke u udhëheq sipas projektit IPA të BE-ZNKE në Kosovë. Gjatë këtij procesi është përdorur një metodologji më e avancuar e procesit tarifar në krahasim me procesin paraprak. Kjo metodologji është diskutuar dhe sqaruar për kompanitë e ujësjellësit dhe kanalizimit shumë herë, për të cilin janë mbajtur disa punëtori dhe janë mbajtur shumë takime individuale.

Karakteristikat kryesore të kësaj metodologjie dhe politikave tarifore të aplikuara kanë qenë;

- dizajnimi për aplikim të dy softuerëve të integruara, njeri për Biznes Planin Rregullatorë dhe tjetri për Modelin Tarifarë nga të cilat janë gjeneruar tarifaf,
- insistimi për implementimin e të gjitha procedurave dhe rregullave të parashkruara me aktet rregullative të proceseve të përcaktimit të tarifave të këtyre shërbimeve,
- monitorimin periodik dhe vjetorë të efekteve të dalja nga tarifaf e reja dhe vlerësimin e përmbushjes së cazeve të përcaktuara me procesin e realizuar tarifarë,
- publikimin e të dhënave nga monitorimi i performancës dhe dhënien e sugjerimeve për ndërmarrjen e veprimeve të ndryshme, për të ndihmuar ngritjen e efikasitetit të punës së kompanive etj.

Parimi i përgjithshëm i punëve të udhëheqjes dhe realizimit të procesit rregullatorë, për përcaktim të tarifave të shërbimeve të ujit në vendin tonë, ka qenë i udhëhequr sipas parimeve të aplikuara në vendet Anglo-Saksone, sikurse është parimi i punës së rregullatorit të ujit Ofwat në Angli dhe Vells dhe pjesërisht edhe të WICS-it në Skotland, në këtë numërojmë;

- mbulimin e plotë të kostove operative,
- lejjimin e shumave të caktuara të investimeve kapitale me financim vetanak të kompanive,
- zhvlerësimin e aseteve mbi tokësore sipas specifikave të përshkruara në Procedurat e Kontabilitetit Rregullatorë (PKRR),

- lejin e një norme mesatare të mjaftueshme dhe stimuluese për kthim në kapital,
- regjistrimin e të dhënave operative dhe financiare sipas PKRR, për ti identifikuar kosto qendrat e këtij sektori,
- monitorimin e performancës dhe editimin e raporteve periodike dhe vjetore, për të vlerësuar shkallën e përmbushjes së caqeve të përcaktuar me procesin rregullatorë të tarifave, etj.

Sipas Rregullës ZRRUM R-02/UeK për Përcaktim të Tarifave të Shërbimit për Shërbimet e Ujësjellësit, Kanalizimit dhe të Furnizimit me ujë me shumicë në Kosovë, 12 Gusht 2008, neni 8. Politikat tarifore, pika 8.5. tarifat e shërbimeve përfshijnë tri kategori të konsumatorëve; (i) konsumatorët shtëpiakë, (ii) konsumatorët komercial-industrial dhe (iii) konsumatorët institucional.

Për ta rrumbullakuar atë që theksuam ma lartë, në vijmë po i pasqyrojmë edhe të dhënat për tarifa të kompletuara nga procesi rregullatorë 2012 – 2014, për të krijuar një përshtypje të plotë të tyre dhe dëshmuar se tarifat Volumetrike kanë pas ngritje të përmbajtur dhe të shkallëzuar, duke i mbuluar kostot operative dhe lejuar një shumë të konsiderueshme për investime kapitale për tri vitet e ardhshme, si dhe duke i ekuilibrar të njëjtat për tu përballuar pagesa e faturave ma lehtë nga konsumatorët dhe për të qenë mjaft stimuluese për kompanitë.

Tarifat e këtij procesi rregullatorë reflektojnë shkallë të caktuar të ndër-subvencionimet tarifore që bëhen në mes të grupimeve dhe kategorive të ndryshme të konsumatorëve, kjo për arsye të rrethanave ekzistuese në vend, me tendencë që kjo vit pas viti të përafrohet gjer te elimini i plotë i ndër subvencionimit mes konsumatorëve.

Tarifat e reja kanë shënuar një ngritje të përmbajtur të tyre në krahasim me tarifat e mëparshme. Kjo ngritje e tarifave është vlerësuar si absolutisht e domosdoshme për t'iu mundësuar kompanive gjenerim të hyrave të nevojshme për mbulimin e kostove të tyre dhe ngritjen e cilësisë së shërbimeve ndaj konsumatorëve.

Tarifat e vitit 2012 janë të pandryshuara pasi në to është marr parasysh Shkalla e Lëvizjes së Indeksit të Çmimeve në Kosovë (SHLIÇK) nga periudha Tetor/2010-Tetor 2011, ndërsa tarifat e viteve 2013 dhe 2014 do të përshtaten sërish me SHLIÇK në Kosovë për periudhat e përcaktuara të këtij procesi rregullatorë.

Tarifat fikse mujore të aplikuar nga kompanitë gjatë vitit 2009-2011 do të mbesin të njëjta edhe për tri vitet e ardhshme 2012-2014.

Tabela nr. 18 Tarifat e aprovuara për Shërbimet e Ujësjellësit dhe Kanalizimit 2012-2014

Kompania Regjionale	Kategoria e tarifave	Njësia	Tarifa për Konsumatorët Shtëpiak			Tarifa për Konsumatorët Jo-shtëpiak		
			2012	2013	2014	2012	2013	2014
KUR 'PRISHTINA' Prishtinë	Fikse	€/muaj	1.00	1.00	1.00	3.00	3.00	3.00
	Volumetrike - Uji	€/m ³	0.37	0.3699	0.3859	0.87	0.8507	0.8682
	Volum.-Kanalizim	€/m ³	0.05	0.0498	0.0556	0.11	0.1146	0.1251
	Volum.-Mesatare	€/m ³	0.42	0.4197	0.4415	0.98	0.9653	0.9933
KUR 'HIDROREGJIONI JUGOR' Prizren	Fikse	€/muaj	1.00	1.00	1.00	3.00	3.00	3.00
	Volumetrike - Uji	€/m ³	0.31	0.3342	0.3722	0.61	0.6518	0.7072
	Volum.-Kanalizim	€/m ³	0.05	0.0491	0.0600	0.09	0.0883	0.0979
	Volum.-Mesatare	€/m ³	0.36	0.3833	0.4322	0.70	0.7401	0.8051

KUR 'HIDRODRINI' Pejë	Fikse	€/muaj	1.00	1.00	1.00	3.00	3.00	3.00
	Volumetrike - Uji	€/m3	0.22	0.2264	0.2474	0.43	0.4529	0.4454
	Volum.-Kanalizim	€/m3	0.06	0.0637	0.0719	0.12	0.1274	0.1439
	Volum.-Mesatare	€/m3	0.28	0.2901	0.3193	0.55	0.5803	0.5893
KUR 'RADONIQI' Gjakovë	Fikse	€/muaj	1.00	1.00	1.00	3.00	3.00	3.00
	Volumetrike - Uji	€/m3	0.33	0.3400	0.3684	0.72	0.6799	0.6631
	Volum.-Kanalizim	€/m3	0.07	0.0839	0.1089	0.16	0.2098	0.2724
	Volum.-Mesatare	€/m3	0.40	0.4239	0.4773	0.88	0.8897	0.9355
KUR 'MITROVICA' Mitrovicë	Fikse	€/muaj	1.00	1.00	1.00	3.00	3.00	3.00
	Volumetrike - Uji	€/m3	0.33	0.3492	0.3841	0.73	0.6985	0.6913
	Volum.-Kanalizim	€/m3	0.08	0.1021	0.1339	0.20	0.2552	0.3347
	Volum.-Mesatare	€/m3	0.41	0.4513	0.5180	0.93	0.9537	1.0260
KUR 'HIDROMORAVA' Gjilan	Fikse	€/muaj	1.00	1.00	1.00	3.00	3.00	3.00
	Volumetrike - Uji	€/m3	0.32	0.3168	0.3256	0.71	0.6335	0.5861
	Volum.-Kanalizim	€/m3	0.08	0.0799	0.0855	0.19	0.1999	0.2137
	Volum.-Mesatare	€/m3	0.40	0.3967	0.4111	0.900	0.8334	0.7998
KUR 'BIFURKACIONI' Ferizaj	Fikse	€/muaj	1.00	1.00	1.00	3.00	3.00	3.00
	Volumetrike - Uji	€/m3	0.31	0.3107	0.3279	0.68	0.6214	0.5902
	Volum.-Kanalizim	€/m3	0.13	0.1301	0.1417	0.30	0.3252	0.3542
	Volum.-Mesatare	€/m3	0.44	0.4408	0.4696	0.98	0.9466	0.9444

Duke marr parasysh konsumin mesatarë mujorë të sektorit për konsumatorët shtëpiakë me ngarkesat tarifore të aplikuar gjatë vitit 2011 e cila ka qenë 6.76 €/muaj, gjatë vitit 2012 me ngritjen e tarifës do të kemi një faturim ma të lartë për të njëjtat grupime të konsumatorëve prej 7.58 €/muaj, ose shprehur në vlerë absolute ngritja e supozuar e faturës nga vitit 2011 në vitin 2012 do të jetë 0.81€/muaj pa llogaritjen e TVSH-ës.

Tarifat e pasqyruara ma lartë janë përcaktuar mbi bazën e kostove të çdo regjioni veç e veç dhe vlejné si të tilla për të gjithë regjionin – pa bërë diskriminimin e konsumatorëve të shërbyer etj.

Në vijm po paraqesim edhe tarifën të cilat duhet ti aplikojë NH "Ibër-Lepenc" sh. a. Prishtinë. për furnizim të konsumatorëve të vet me ujë të pa trajtuar me shumicë do të aplikoj tarifën e pasqyruar në tabelën e më poshtme.

Tabela nr. 19. Tarifat për furnizim të ujit me shumicë të pa trajtuar për vitin 2012

Numri rendor	Shfrytëzuesit e ujit me shumicë të pa trajtuar	Njësia matëse	Tarifa
1	KUR "Prishtina" Sh. A. Prishtinë për Drenas	€/m3	0,0455
2	KUR "Mitrovica" Sh. A. Mitrovicë	€/m3	0,0184

Tarifat e pasqyruara në këto dy tabela janë pa TVSH.

Për informata ma të plota për tarifën e përcaktuar për periudhën kohore 2012-2014, për të gjitha KRU-të sugjerojmë të shikoni ueb faqen tonë <http://wwro-ks.org>, Tarifën, Procesin tariforë 2012-2014 Raporti i Tarifave për Shërbimet e Furnizimit me Ujë dhe Shërbimeve të Ujërave të zeza 2012-2014, faqe 39 deri në 41.

3.3.1.2. Tarifën e shërbimit të administrimit me mbeturina 2011-2012

Udhëheqja e procesit të përcaktimit të tarifave një (1) vjeçare për shërbimin e administrimit të mbeturinave të ngurta komunale, ka filluar nga gjysma e muajit shkurt 2011 dhe është përfunduar në fund të muajit Maj të të njëjtit vit. Edhe për këto shërbime sipas Rregullës ZRRUM R-02/M, për Përcaktim të Tarifave të Shërbimit për Shërbimet e Grumbullimit dhe Deponimit të Mbeturinave në Kosovë, 12 gusht 2008, nëni 9 Kategoritë e Konsumatorëve për Përcaktimin e Tarifave të Shërbimeve për shërbimet e grumbullimit dhe administrimit të mbeturinave të ngurta komunale, pika 9.1., Kategoritë e konsumatorëve i përkufizon në; (i) konsumatorë shtëpiakë, (ii) konsumatorë komercial-industrial dhe (iii) konsumatorë institucional.

Afati i vlefshmërisë së tarifave të këtij shërbimi ndërlidhen me periudhën kohore: 1 Qershor 2011 – 31 Maj 2012.

Parimet e përcaktimit të tarifave një (1) vjeçare janë mbështet s'paku në pesë (5) kritere dhe praktika të njohura ekonomike, të cilat i kemi pas si pikë nisje që nga tarifën e para të përcaktuar nga ky rregullatorë gjatë vitit 2006 për këto shërbime, nga të cilat po përmendim:

- mbulimin e plotë të kostove operative të ofruesit të shërbimeve, edhe pse të njëjtat nga aspekti ekonomik në fillim mund të ishin të diskutueshme,
- njohjen si kosto të një shume të caktuar të llogarive të arkëtueshme të pa mbledhshme, të cilat supozohet se nuk mund të inkasohen në rrethanat aktuale të shoqërisë sonë me tendencë kah ulja e tyre, marrjen në konsideratë të mbulimit të një shume të caktuar të kostove të investimeve kapitale me tarifë,
- gjykimin tonë për balancim të tarifave për tu mundësuar kompanive me i mbuluar kostot e tyre të operimit dhe konsumatorëve për ti paguar faturat për shërbimet që i marrin,
- tarifën janë përcaktuar dhe vazhdojnë të caktohen në bazë të kostove të çdo regjioni veç e veç dhe vlejné si të tilla për të gjithë regjionin – pa bërë diskriminim të konsumatorëve të shërbyer etj.

Disa informata shtesë nga metodologjia e përcaktimit të tarifave të këtij shërbimi të cilat kanë qenë të aplikuara ma parë dhe të cilat janë implementuar edhe gjatë procesit të fundit, mund të jetë me interes për tu përmend me qëllim informimi edhe kësaj radhe;

- tarifën për shërbimet e bashkësive familjare janë unike në regjion,
- tarifën komerciale-industriale janë të diferencuara varësisht se me cilin grupim të konsumatorëve kemi të bëjmë – kriter themelorë lokacioni i vendndodhjes së tyre, sasia e mbeturinave të prodhuara dhe madhësia e tyre, dhe
- tarifën institucionale të cilat po ashtu janë të diferencuara sipas praktikës së tarifave të grupimit të konsumatorëve komercial – industrial.

Modelet e tilla të përcaktimit të tarifave janë të thjeshta dhe në të ardhmen pas një qasje të re që duhet ti referohemi dhe diskutimeve të gjëra, për këtë shërbim duhet marr parasysh edhe kategori të reja ekonomike për ti futë si kosto të reja reale, me të cilat do të ngarkohen tarifën e të cilat mund të identifikohen;

- varësisht nga kompozueshmëria e mbeturinave (shpërbërjes së lehtë, ose të vështirë),

- ngarkesa tjera shtesë për mbrojtën e mjedisit të njohura si taksa ekologjike,
- përmirësim të infrastrukturës manipuluese për asgjësim të materieve me ndotje të rëndë,
- përshtatjen e kategorizimeve të mbeturinave, konsumatorëve në përputhje me Direktivat e Bashkimit Evropianë (DBE) për këto shërbime etj.

Duhet theksuar se tarifat e përcaktuara edhe për vitin e fundit rregullatorë reflektojnë shkallë të caktuar të ndër-subvencionimit tarifore që bëhen në mes të grupimeve dhe kategorive të ndryshme të konsumatorëve, kjo për arsye të rrethanave ekzistuese, me tendencë që kjo vit pas viti të përafrohet gjer te eliminimi i plotë i ndër-subvencionimit të tillë.

Ne mendojmë se tarifat e përcaktuara për periudhën e raportuar, kanë qenë dhe janë optimale dhe të drejta, duke marr parasysh pozitën e vështirë financiare që kanë kompanitë që ofrojnë këto shërbime, duke pas në konsideratë edhe mundësin e pagesës së konsumatorëve për shërbimet që i marrin dhe gjendjen socio-ekonomike të vendit. Sikurse që kemi marr në konsideratë edhe mbajtjen e një mjedisi të pastër ashtu si e dëshirojmë ta kemi të gjithë.

Do të ishte e pa përshtatshme pasqyrimi i të gjitha tarifave në këtë raport pune, pasi që bëhet fjalë për tetë (8) kompani regjionale për administrim me mbeturina dhe specifike të veçanta të tyre, pasi konsumatorët komercial-industrial dhe institucional kanë disa kategori dhe grupime. Prandaj për këtë rast po i pasqyrojmë vetëm tarifat e shërbimeve për konsumatorët shtëpiakë në pasqyrën e më poshtme.

Tabela nr. 20. Tarifat e shërbimit për administrim të mbeturinave 06/2011-05/2012

Numri rendor	Emërtimi i kompanive	Tarifa e shërbimit 06/2010-05/2011 €/muaj	Tarifa e shërbimit 06/2011-05/2012 €/muaj	% e tarifës së ngritur nga një vit te tjetri
1	KRM "Pastrimi" sh. a. Prishtinë	4,14	4,14	0,00
2	KRM "Çabrat" Sh. a. Gjakovë	4,31	4,48	3.94
3	KRM "Pastërtia" Sh. a. Ferizaj	4,01	4,31	7,48
4	KRM "Higjiena" Sh. a. Gjilan	3,93	4,14	5.34
5	KRM "Eko-Regjioni" Sh. a. Prizren	3,88	3,88	0.00
6	KRM "Ambienti" Sh. a. Pejë	3,45	3,45	0,00
7	KRM "Uniteti" Sh. A. Mitrovicë	3,45	3.80	10,14
	Mesatarja e tarifave për konsumatorët shtëpiakë prej 1-7	3,88	4,03	3.87
8	KMDK Sh. a. Prishtinë	5,26 €/ton	5,26 €/ton	0,00

Tarifat e pasqyruara në këtë tabelë janë pa TVSH.

Për shkak të hapësirës dhe ndërlikueshmëris së prezantimit tarifat e shërbimeve për grupimin e konsumatorëve biznes-industri dhe ata institucional mund ti gjeni në ueb-faqen tonë të theksuar ma lartë.

Për informata ma të plota për tarifat e përcaktuara për shërbimin e grumbullimit dhe administrimin e mbeturinave të ngurta komunale për Qershor 2011 – Maj 2012 për të gjitha KRM-të sugjerojmë

të shikoni ueb faqen tonë <http://wwro-ks.org>, Tarifat, Urdhëresat tarifore 06/2011 – 05/2012, Urdhëresat Tarifore për Shërbimet e Grumbullimit të Mbeturinave.

3.3.2. Monitorimi 9 mujor i të dhënave operative dhe financiare i KRU`ve

Gjatë vitit 2011 ZRRUM tri herë radhazi (një herë për vitin 2010 dhe dy herë për vitin 2011) ka monitoruar performancën e përgjithshme të çdo kompanie veç e veç dhe sektorit si tërësi që ofrojnë shërbime të ujit në vend dhe përshtypja e përgjithshme është se të njëjtat kanë dështuar në përmbushjen e caqeve, të përcaktuar me procesin rregullator të viteve 2009, 2010 dhe 9 mujorin e parë të vitit 2011.

Monitorimi përfundimtarë për vitin 2011 do të bëhet në gjysmën e parë të vitit 2012, pasi që të kompletohen të dhënat e përgjithshme nga kompanitë.

Nga të dhënat e monitoruar duhet përmend;

- të dhënat operative,
- të dhënat financiare , dhe
- të dhënat e realizimit të projekteve investive kapitale

3.3.2.1. Të dhënat operative

Për analizë të të dhënave operative kemi marr parasysh të dhënat sasiore për metër kub (m³): (I) uji i prodhuar, (II) uji i humbur apo i pa faturuar, (III) faturimin e ujit të furnizuar, (IV) faturimin e ujërave të zeza të grumbulluara; (V) numrin e konsumatorëve. Të dhënat janë paraqitë në formë tabelore të sistemuara në tri kolona, ku janë pasqyruar të dhënat historike për nëntë mujorin e parë të vitit 2010 për krahasim, të dhënat e aprovuara nga ZRRUM për nëntë mujorin e parë të vitit 2011 dhe të dhënat e realizuara nga KRU-të për nëntë (9) mujorin e parë të së njëjtës periudhë kohore dhe në dy kolona tjera është paraqitur përqindja e përmbushjes, mospërmbushjes së caqeve dhe vlerësimi përfundimtarë për përdhën e shikuar të vitit 2011.

Në këtë pjesë të këtij raporti për shkak të hapësirës do të pasqyrohen vetëm disa të dhënat sektoriale duke mënjanuar edhe përshkrimin tekstual. Për të dhëna të plota mund të shikoni; <http://wwro-ks.org>, Tarifat, Raportet, Raport mbi Përmbushjen e Objektivave 2009-2011.

Tabela Nr. 21 Pasqyra e të dhënave sektoriale për ujin e prodhuar, ujin e humbur, faturimin e ujit të furnizuar, faturimin e ujërave të zeza të grumbulluara, numrin e konsumatorëve, % e përmbushjes së caqeve dhe vlerësimin përfundimtarë për 9 mujorin e parë të vitit 2011.

Të dhënat për sektorin	Njësia	Historike 9m 2011	Aprovuara 9m 2011	Realizuara 9m 2011	Ndryshimi në %	Vlerësimi përfundimtar
Uji i prodhuar	m ³	104,591,080	104,855,009	109,555,540	4.48%	Pozitiv
Uji i humbur		62,565,401	49,943,261	67,074,294	34.30%	Negativ
Uji i faturuar		42,025,679	54,911,748	42,481,246	-22.64%	Negativ
Ujërat e zeza të faturuara		30,644,558	42,088,880	27,746,823	-34.08%	Negativ
Numri i konsumatorëve	Nr.	242,282	220,863	229,763	4.03%	Pozitiv

Kur shikohen të dhënat sektoriale, mund të konstatohet se sasia e ujit të prodhuar dhe numri i konsumatorëve kanë trend pozitiv, por për prodhimin e ujit nuk mund të epet vlerësim pozitivë pasi që me prodhimin e ujit kemi shtim të humbjeve të sasisë së ujit të prodhuar, e si rezultat përfundimtarë edhe ky tregues vlerësohet negativisht.

3.3.2.2. Të dhënat financiare

Edhe këtë grupim të të dhënave do të paraqesim në formë tabelore, duke i identifikuar shërbimet e ujit dhe shërbimet e ujërave të zeza për nëntë mujorin e parë të vitit 2011 dhe vitin krahasues 2010, për të vlerësuar shkallën e përmbushjes së objektivave të përcaktuara për periudhën e shikuar 9 mujore të vitit 2011 dhe jo ato vjetore, pasi që të njëjtat akoma nuk janë përmbyllur dhe as që janë përpunuar nga kompanitë e as nga ne.

Edhe në këtë rast do të paraqiten të dhënat e përmbledhura sektoriale.

Tabela nr. 22. Pasqyra përmbledhëse sektoriale e shpenzimeve operative për 9 mujorin e parë të vitit 2011 për KRU-të

	Shpenzimet operative	Njësia matëse	Σ e shpenzimeve 9 mujore 2010	Σ e aprovuar nga ZRRUM 9 mujore 2011	Σ e realizuar nga KRU-të 9 mujore 2011	% e realizimit për 9 mujorin e vitit 2011
Të dhënat e përgjithshme të sektorit	Stafi (personeli)	€	6,143,769	6,423,053	6,394,528	-0.44
	Energjia elektrike	€	2,449,098	2,189,009	2,852,836	30.33
	Shpenzimet tjera operative	€	2,991,723	4,043,260	3,180,445	-21.34
	Σ e shpenzimeve operative	€	11,584,590	12,655,322	12,427,809	-1.80

Në tabelën nr. 22. janë pasqyruar kostot e aprovuara dhe ato të ndodhura nga kompanitë gjatë 9 mujorit të parë të vitit 2011 dhe të dhënat krahasuese të së njëjtës përdhë për vitin 2010, sikurse edhe vlerësimin përfundimtarë i sektorit të bërë nga ZRRUM për atë periudhë.

Brenda tyre ka ngritje të shpenzimeve të energjisë elektrike dhe ulje të theksuar të shpenzimeve për riparime dhe mirëmbajtje kapitale, gjë që vlerësohet negativisht.

3.3.2.3. Mbulimi i shpenzimeve të përgjithshme operative nga shuma e arkëtimit

Në tabelën e më poshtme përveç shpenzimeve të përgjithshme operative kemi shtuar edhe shpenzimet apo kostot e shumës së investimeve vetanake për nëntë mujorin e parë të vitit 2011.

Tabela. Nr. 23. Pasqyra mbi të dhënat e mbulueshmërisë së të hyrave të arkëtuara me shpenzimet e përgjithshme operative direkte të ndodhura gjatë nëntë mujorit të parë të vitit 2011, në këtë tabelë është futur edhe shuma e investimeve vetanake për nëntë mujorin e parë të vitit 2011.

Nr	Emri i kompanisë	Arketimi	Shpenzimet operative pa amortizim	Mbetja Financiare	Investimet Kapitale Vetanke	Shkalla e mbulueshmërisë
	€	€	€	€	€	
	A	B	C	D=(B-C)	E	F=B/(C+E)
1	Prishtina	5,805,787	5,472,047	333,740	545,949	0.96
2	Mitrovica	828,222	1,347,405	-519,183	0	0.61
3	Hidrodrini	1,230,861	1,146,311	84,550	51,994	1.03
4	Radoniqi	1,392,095	1,364,316	27,779	1,155	1.02
5	Hidroregjioni-Jugor	1,693,558	1,772,427	-78,869	68,207	0.92
6	Bifurkacioni	516,526	524,099	-7,573	2,422	0.98
7	Hidromorava	787,306	801,204	-13,898	0	0.98
	Te dhenat sektoriale	12,254,355	12,427,809	-173,454	669,727	0.94

Shënim: Të dhënat për KRU "Mitrovica" sh. a. Mitrovicë janë pa shumën e subvencionimit për faturimet e bëra për pjesën veriore të qytetit për periudhën e shikuar.

3.3.2.4. Faturimi dhe arkëtimi

Në tabelën e më poshtme janë pasqyruar të dhënat sektoriale për faturim dhe inkasim për 9 mujorin e parë të vitit 2011, të cilat dëshmojnë për dështim në përmbushjen e caqeve të përcaktuara me procesin tariforë 2009-2011, për periudhën e shikuar.

Tabela Nr. 24. Pasqyra e të dhënave sektoriale për faturim dhe arkëtim për nëntë mujorin e parë të vitit 2011

Te dhenat fianciare	Njesia	Faturimi dhe arkëtimi per dy sherbimet		Perqindja e realizimit te cakut %	Vlerësimi perfundimtar
		Aprovuara 9m 2011	Realizuara 9m 2011		
Faturiumi	€	24,312,194	18,564,658	-23.64%	Negativ
Arkëtimi	€	19,247,619	12,254,355	-36.33%	Negativ

Shpjegim:

Duke pasur parasysh se asnjëra nga KRU-të në Kosovë nuk kanë arritur me i përmbush caqet e përcaktuara për faturim dhe arkëtim me procesin rregullatorë 2009-2011 për periudhën e shikuar të vitit 2011, rregullatori i performancës së sektorit në përgjithësi e vlerëson si tejet negative dhe jo eficiente për periudhën e nëntë mujorit të parë të vitit 2011.

3.3.2.5. Të dhënat për investimet kapitale

Nga pasqyrat e më poshtme mund të shihet se as njëra nga kompanitë nuk kanë realizuar investimet kapitale të planifikuara me procesin rregullatorë të viteve 2009, 2010, e as për periudhën e shikuar 9 mujore të vitit 2011 dhe sipas të gjitha gjasave as për vitin 2011. Në dy pasqyra të ndara do të pasqyrohen të dhënat e planifikuara për financim të investimeve nga burimet vetanake të kompanive dhe nga grantet e ndryshme për të njëjtat.

Tabela Nr. 25. Pasqyra e shumës së investimeve **vetanake** të planifikuara nga KRU-të dhe të aprovuara nga ZRRUM për 9 mujorin e parë të vitit 2011, si dhe ato të realizuara nga KRU-të gjatë nëntë mujorit të parë të vitit 2011.

INVESTIMET VETANAKE						
Nr	Emri i Kompanisë	Investimet e planifikuara nga KRU-të për 9 m 2011	Investimet e lejuara për 9 m 2011	Investimet e realizuara gjatë 9 m te vitit 2011	Përqindja e realizimit të cakut	Vlerësimi përfundimtar vjetor
		€	€	€	%	
1	Prishtina	2,510,400	3,429,449	545,949	-84.08%	Negativ
2	Mitrovica	441,413	512,717	0	-100.00%	Negativ
3	Hidrodrini	1,480,425	829,747	51,994	-93.73%	Negativ
4	Radoniqi	668,858	1,069,935	1,155	-99.89%	Negativ
5	Hidroregjioni Jugor	434,025	843,894	68,207	-91.92%	Negativ
6	Bifurkacioni	341,100	546,224	2,422	-99.56%	Negativ
7	Hidromorava	276,038	464,579	0	-100.00%	Negativ
	Totali	6,152,258	7,696,543	669,727	-91.30%	Negativ

Kjo tabelë pasqyron saktë shkallën e realizueshmërisë së investimeve kapitale të financuara nga mjetet vetanake të kompanive dhe të sektorit në përgjithësi për 9 mujorin e parë të vitit 2011.

Tabela Nr. 26. Pasqyra e shumës së investimeve të planifikuara nga donatorët për tu realizuar te KRU-të, ato të aprovuara nga ZRRUM për realizim për 9 mujorin e parë të vitit 2011, si dhe shkallën e realizueshmërisë së tyre gjatë periudhës së shikuar.

INVESTIMET NGA DONATORET						
Nr	Emri i Kompanisë	Investimet e planifikuara nga KRU-të për 9m 2011	Investimet e lejuara për 9m 2011	Investimet e realizuara gjatë 9m të vitit 2011	Përqindja e realizimit të cakt	Vlerësimi përfundimtar vjetor
		€	€	€	%	
1	Prishtina	18,030,000	18,030,000	0	-100%	Negativ
2	Mitrovica	397,500	397,500	53,430	-87%	Negativ
3	Hidrodrini	742,500	742,500	699,653	-6%	Negativ
4	Radoniqi	2,596,778	2,596,778	18,188	-99%	Negativ
5	Hidroregjioni Jugor	5,765,083	5,765,083	1,001,846	-83%	Negativ
6	Bifurkacioni	543,750	543,750	136,111	-75%	Negativ
7	Hidromorava	712,500	712,500	0	-100%	Negativ
	Totali	28,788,110	28,788,110	1,909,228	-93%	Negativ

Këto dy tabela pasqyrojnë saktë shkallën e mos realizimit të objektivave të përcaktuara nga dy burimet financiare të planifikuara në kompani, për investime gjatë periudhës së shikuar të procesit rregullator të vitit 2011 sikurse që ka ndodh edhe për dy vitet tjera paraprake.

3.4. PROMOVIMI I INTERESAVE TË KONSUMATORËVE

3.4.1. Zbatimi i standardeve të shërbimit

Me qëllim të përmirësimit të standardeve të shërbimeve ndaj konsumatorëve, nga ana e ZRRUM-it janë ndërmarrë aktivitete të gjithanshme si:

- organizimi i punëtorive dhe debateve me kompanitë dhe palët e tjera të interesit ku janë diskutuar dhe janë bartë përvojat më të mira ndërmjet kompanive,
- dhënia e rekomandimeve për kompanitë e ujit dhe kërkimi i zotimeve specifike nga to, për përmbushjen dhe përmirësim të ndjeshëm të nivelit të shërbimeve ndaj konsumatorëve.

Si rezultat i këtyre aktiviteteve, në pothuajse të gjitha kompanitë e ujit, janë themeluar zyra për relacione me konsumatorë. Këto zyra janë pajisur me personel dhe infrastrukturë të nevojshme për trajtimin efikas të ankesave të konsumatorëve.

Po ashtu, në bashkëpunim të ngushtë me Institutin Kombëtar të Shëndetit Publik të Kosovës (IKSHPK), ZRRUM në vazhdimësi ka përcjell cilësinë e ujit të pijes dhe me kohë ka reaguar kur ka pasur dështime të cilësisë së ujit.

3.4.2. Trajtimi i ankesave të konsumatorëve përmes KKK-ve

Performanca e Komisioneve Këshilluese të Konsumatorëve

Një ndër funksionet dhe përgjegjësitë më të rëndësishme të ZRRUM është edhe mbrojtja e qëndrueshme e interesave të konsumatorëve duke u përkujdesur, që shërbimet që atyre iu ofrohen nga Kompanitë e licencuara janë në nivelin e standardeve të përcaktuara, dhe se ata kanë në dispozicion mekanizma efektiv për adresimin e ankesave dhe pakënaqësive të tyre. Me qëllim të realizimit të këtyre interesave, konform Nenit 7.1 të Rregullës për Komisionin Këshillues të Konsumatorëve për Shërbimet e Ujit dhe Mbeturinave në Kosovë (R-08/U&M)), nga data 05 prill 2011, është paraparë Themelimi i Komisioneve Këshilluese të Konsumatorëve (KKK), si dhe janë përcaktuar modalitetet dhe funksionimi i këtyre Komisioneve. Andaj, në harmoni me këto dispozita, ZRRUM në qershor të vitit 2011, pas shqyrtimit të propozimeve nga Kuvendet Komunale, intervistave dhe konsultimeve të bëra, ka bërë themelimin e Komisioneve Këshilluese të Konsumatorëve në 7 Regjione të Kosovës, sipas Planit për Konsolidimin e Ofruesve të Shërbimeve të Ujit dhe Ujërave të Zeza dhe Mbeturinave dhe në përputhje me rregullën e amendamentuar në mars të këtij viti.

Secila komunë brenda Regjionit të përcaktuar i ka 1 (një) përfaqësues respektiv në KKK..

Edhe gjatë vitit 2011, ZRRUM i ka ofruar mbështetje të gjithanshme materiale, logjistike dhe organizative, për të gjitha KKK.

Gjithashtu janë evidente disa suksese të rëndësishme në punën e tyre që konsistojnë:

- Në KKK janë të përfaqësuar të gjitha komunat të cilat i janë nënshtruar procesit të konsolidimit dhe të rajonalizimit, përfshirë edhe komunat të cilat me vendime të një anshme janë larguar nga Kompanitë Rajonale.
- Janë mbajtur takime të rregullta në baza mujore, ku janë shqyrtuar dhe zgjedhur një numër i konsiderueshëm i ankesave dhe kërkesave në mes të Konsumatorëve dhe KRU, si dhe janë shqyrtuar dhe janë dhënë rekomandime për shumë çështje rregullatore.
- Numri i ankesave të parashtruara dhe të zgjidhura në KKK, në vazhdimësi janë në rritje nga viti në vit, po ashtu edhe në vitin 2011 në krahasim me vitin 2010, kemi një rritje në numrin e ankesave të parashtruara dhe të shqyrtuara, dhe kjo është si rezultat i një aktiviteti të shtuar të KKK.
- Vendosja e bashkëpunimit të ngushtë dhe korrekt me Ofruesit e Shërbimeve, Shoqatat, Institucionet, si dhe projektet e ndryshme të cilat kanë në fokus konsumatorin, e sidomos me projektin Mbështetja e Mëtitutjeshme Institucionale për ZRRUM-in, i cili financohet nga BE dhe menaxhohet nga Zyra Ndërlidhëse e Komisionit Evropian (ZNKE), **OJÇ “Konsumatori”** si dhe me **Ministrinë e Tregtisë dhe Industrisë** dhe **Ministrinë për Punë dhe Mbrojtje Sociale** dhe **Asociacionin e Komunave**.

Në vijim është dhënë në formë tabelore, numri dhe struktura e ankesave të parashtruara dhe të shqyrtuara nga KKK-të regjionale në vitin 2011.

Tabela 27. Numri i Ankesave të Parashtruara KKK

REGJIONI	Janar	Shkurt	Mars	Prill	Maj	Qershor	Korrik	Gusht	Shtator	Tetor	Nëntor	Dhjetor	Gjithsejt
KKK Prishtinë	4	5	3	3	1	9	1	5	2	3	1	1	38
KKK Mitrovicë	-	-	-	-	-	-	-	-	-	2	-	-	2
KKK Pejë	-	-	-	-	-	-	-	1	-	-	-	-	1

KKK Gjakovë	1		3	1	-	-	-	4	-	2	1	-	12
KKK Prizren	-	-	-	1	-	-	-	-		2	-	-	3
KKK Ferizaj	-			1	1	-	-	-		1	-	-	3
KKK Gjilan	-	-	-	-	-	2	1	-		1	1	-	5
Gjithsejtë	5	5	6	6	2	11	2	10	2	11	3	1	64

Tabela 28. Numri i Ankesave të Zgjedhura nga KKK

REGJIONI	Janar	Shkurt	Mars	Prill	Maj	Qershor	Korrik	Gusht	Shtator	Tetor	Nëntor	Dhjetor	Gjithsejt
KKK Prishtinë		1	-	-	-	2	-	1	2	2	1	1	10
KKK Mitrovicë	-	-	-	-	-	-	-	-	-	2	-	-	2
KKK Pejë	-	-	-	-	-	-	-	1	-	-	-	-	1
KKK Gjakovë	-	-	-	-	-	-	-	4	-	1	-	-	5
KKK Prizren	-	-	-	1	-	-	-	-	-	2	-	-	3
KKK Ferizaj	-	-	-	-	1	-	-	-	-	1	-		2
KKK Gjilan	-	-	-	-	-	1	-	-	-	-	1	-	2
Gjithsejtë	-	1	-	1	1	3	-	6	2	8	2	1	25

Nga tabelat shihet se KKK të konsumatorëve në regjionin e Prishtinës i kanë arritur me shumë ankesa të cilat kanë të bëjnë me KRU 'Prishtina', gjithsejtë 38 duke u pasuar nga KKK i Gjakovës, i cili ka pranuar 12 ankesa. Nga tërë numri prej 64 ankesave, vetëm 25 prej tyre janë zgjedhur përderisa 9 janë kthyer për plotësim lënde dhe 29 i janë kthyer KRU-ve për ti Zgjidhur. Natyra e ankesave kryesisht është për shkak të Faturimit Paushall, Zbritja/Shlyerja e Borxhit por edhe për shkak së tarifave janë të larta. Numri më i madh i ankesave 59 kanë arritur nga Konsumatorët Shtëpiak, përderisa vetëm 5 janë nga kategoria e konsumatorëve jo shtëpiak.

4. Aktivitetet në Konsolidimin Institucional

4.1. AKTIVITETET NË PLANIN LEGJISLATIV

Kemi dhënë kontributin në amandamentimin e ligjit të Mbeturinave, s' këndejmi ZRRUM është i shqetësuar në lidhje me Projekt Ligjin e Mbeturinave, i hartuar nga MMPH dhe dërguar për Aprovim në Kuvend, i cili (Neni 82) shfuqizon Ligjin mbi Veprimtaritë e Ofruesve të Shërbimeve të Ujësjellësit, Kanalizimit dhe Mbeturinave (Ligji Nr. 03/L-D86), duke bërë de-rregullimin e plotë të sektorit të mbeturinave të ngurta komunale dhe duke i shpërndarë kompetencat aktuale të ZRRUM (Licencimin, tarifat, standardet e shërbimit, etj) tek MMPH dhe Komunat. Ne shqetësimet tona i kemi adresuar tek institucionet relevante, Komisionin Parlamentar për Bujqësi dhe Zhvillim Rural, dhe presim që ato të merren në konsideratë.

(I) Amandamenti i Legjislacionit Sekondar – Rregullat e ZRRUM

Në janar të vitit 2005, ZRRUM ka nxjerrë 14 akte nënligjore (Rregulla) në pajtim me Rregulloren e UNMIK 2004/49 të cilat Rregulla më detajshet i rregullojnë aspektet e caktuara që janë në kuadër të autorizimeve dhe përgjegjësisë të tij si: licencimi, tarifat, standardet e shërbimit, karta e konsumatorëve, shkyçja etj.

Në vitin 2011 ZRRUM, ka vendosur që ti amandamentoj këto Rregulla:

1. *Rregulla për Standardet Minimale të Shërbimit të Ofruesve të Shërbimeve të Ujit në Kosovë ("R03/U&K"). Qëllimi i amandamentimit të kësaj Rregulle ka të bëjë me këto ndryshime që:*

- Uji i cili konsumohet nga konsumatorët duhet të matet me ujëmatës,
- I tërë rrjeti i ujërave të zeza duhet të pastrohet së paku një herë në dy (2) vite
- Në ndërtesat e banimit kolektiv ku nuk ka mundësi teknike për vendosjen e ujëmatësve individual, faturimi i konsumit të ujit të llogaritet në bazë të ujëmatësit kryesor (të përbashkët) dhe të ju shpërndahet të gjithë konsumatorëve të asaj ndërtese në bazë të numrit të anëtarëve të bashkësisë familjare.
- Nënshkrimi i Kontratës për Shërbime

2. *Rregulla për Komisione Këshilluese të Konsumatorëve për Shërbimet e Ujit dhe të Mbeturinave në Kosovë ("R08/U&M"). Qëllimi i amandamentimit ka :*

- Fuqizimi dhe sensibilizimi i rolit të KKK
- Organizimi dhe përfaqësimi i secilës Komunë me nga një përfaqësues në KKK
- Mbështetja institucionale e ZRRUM për të promovuar vetëdijesimin e konsumatorëve për aktivitetet e KKK
- Përcaktimi i saktë i detyrave, dhe efikasiteti i KKK
- Të shqyrtojë dhe zgjedh ankesat e parashtruara nga konsumatorët, të cilët nuk janë trajtuar në mënyrë të duhur, në pajtim me dispozitat në fuqi nga Ofruesit e Shërbimeve.

Që të dy Rregullat janë amendamentuar në bashkëpunim të plotë me Projektin Mbështetës të ZRRUM-it, i cili financohet nga BE dhe implementohet nga konzorciumi i IPA-as, e i cili mbikëqyrret nga ZNKE, dhe janë në favor të mbrojtjes së konsumatorëve.

(II) Përtëritja – Licencimi i Ofruesve të Shërbimit

Me që afati i Licencave të Shërbimit për Kompanitë Rajonale të Mbeturinave ("KRM") skadonte më 30.11.2011, ZRRUM, në afatin ligjor ka filluar me licencimin e këtyre kompanive.

Kompanitë Rajonale të Licencuara gjatë 2011

Kompania Regionale e Mbeturinave	Zonat e shërbimit-Komunat	Data e Lëshimit	Numri i L.SH	Data e Skadimit	Aktiviteti i Autorizuar sipas L.SH
PASTRIMI Prishtinë	Prishtinë, Obiliq, Fushë Kosovë, Lipjan, Podujevë, Glllogoc. Graçanicë.	01/ 12/ 2011	571/DL&L	30/11/2012	Shërbimet e Grumbullimit të Mbeturinave
AMBIENTI Pejë	Pejë, Istog, Klinë, Deçan, Junik.	01/ 12/ 2011	573/DL&L	30/11/2012	Shërbimet e Grumbullimit të Mbeturinave
EKOREGJIONI Prizren	Prizren, Rahovec, Suharekë, Malishevë, Dragash, Mamusha.	01/ 12/ 2011	575/DL&L	30/11/2012	Shërbimet e Grumbullimit të Mbeturinave
ÇABRATI Gjakovë	Gjakovë.	01/ 12/ 2012	574/DL&	30/11/2012	Shërbimet e Grumbullimit të Mbeturinave
PASTERTIA Ferizaj	Ferizaj, Kaçanik, Shtime Hani i Elezit Shtrpce	01/ 12/ 2011	577/DL&L	30/11/2012	Shërbimet e Grumbullimit të Mbeturinave
UNITETI Uniteti	Mitrovicë, Vushtrri, Skenderaj.	01/ 12/ 2011	572/DL&L	30/11/2012	Shërbimet e Grumbullimit të Mbeturinave
HIGJIENA Gjilan	Gjilan, Kamenicë, Viti, Novo Berde, Ranillug, Kollokot, Partesh.	01/ 12/ 2011	576/DL&L	30/11/2012	Shërbimet e Grumbullimit të Mbeturinave

Edhe pse KRM, me rastin e dorëzimit të aplikacionit, nuk e kanë plotësuar kushtin e pagesës së taksës së licencimit ndaj ZRRUM, Licencat e Shërbimit për Ofruesit e Shërbimeve për Grumbullimin e Mbeturinave janë lëshuar në kohëzgjatje vetëm prej 1 (një) viti, me kushte plotësuese nga arsyja:

- E mos qëndrueshmërisë financiare të Kompanive respektive,
- Duke pasur parasysh Vizionin dhe Misionin e ZRRUM,
- Mbrojtjen e mjedisit,
- Mbrojtja e shëndetit të qytetarëve,
- ZRRUM në pajtim me nenin 7.4 të Ligjit, nuk mundë të siguroj se ofrimi i shërbimeve nuk do të ndërpritet konsumatorëve në rast se Kompanitë respektive nuk do të licencohen.

(III) Komisioni shqyrtues

Në bazë të nenit 34 të Ligjit Nr. 03/L-086 për Ndryshimin e Rregullores së UNMIK-ut Nr. 2004/49 mbi Veprimtaritë e Ofruesve të Shërbimeve të Ujësjellësit, Kanalizimit dhe të Mbeturinave, Komisioni shqyrtues ka mandatë shqyrtimin e ankesave nga ofruesit e shërbimeve ndaj çdo vendimi sjellë nga Rregullatori në pajtim me nenin 33, me kusht që kërkesa të jetë bërë me shkrim brenda 15 (pesëmbëdhjetë) ditësh pune nga data e vendimit të Rregullatorit. Për t'i ikur dyshimit, urdhëratë dhe rregullat e lëshuara nga Rregullatori në pajtim me këtë Rregullore gjithashtu i nënshtrohen shqyrtimit nga ana e Komisionit shqyrtues, nëse ofruesi i shërbimit parashtrohet kërkesën për një shqyrtim të tillë.

Komision shqyrtues përbëhet nga kryesuesi i emëruar nga Kuvendi, një anëtar i emëruar nga Rregullatori dhe një anëtar i emëruar nga ofruesi i shërbimeve, i cili ka parashtuar kërkesë për shqyrtim.

Në vitin 2011, Komisioni shqyrtues ka shqyrtuar dy ankesa:

1. Ankesën e Kompanisë për Menaxhimin e Deponive të Mbeturinave në Kosovë, Sh. A (më tutje: KMDK), ndaj vendimit të ZRRUM-it me të cilin vendim gjohet KMDK në vlerë prej 5.000.00 (mijë) euro për shkak se, sipas ZRRUM-it, KMDK ka caktuar tarifa në mënyrë arbitrare dhe pa marrë pëlqimin paraprak të ZRRUM-it, në shqyrtimin e ankesës së Komisionit Shqyrtues, në përbërje të Kryesuesit të emëruar prej Kuvendit të Kosovës, përfaqësuesit të KMDK-së, dhe përfaqësuesit të ZRRUM-it. Mandej, pas shqyrtimit të gjithanshëm të vendimit, ankesës, dhe prezantimit të argumenteve nga palët, Komisioni Shqyrtues ka konstatuar se, KMDK-ja duke caktuar tarifa në mënyrë të njëanshme pa marrë pëlqimin paraprak të ZRRUM-it, ka bërë shkelje të nenit 9. 1 dhe 10. 1 të Ligjit Nr. 03/L-086, dhe nenit 28. 1 të Rregullës për Përcaktimin e Tarifave të Shërbimit për Shërbimet e Grumbullimit dhe Deponimit të Mbeturinave në Kosovë. Për këtë arsye, Komisioni Shqyrtues ka vendosur të mbetet në fuqi vendimi i ZRRUM-it për gjohjet dhe të hidhet poshtë ankesa e KMDK-së.
2. Gjithashtu, Komisioni Shqyrtues ka shqyrtuar ankesën e Kompanisë Regjionale të Mbeturinave, "Uniteti", Mitrovicë, Sh. A, ndaj vendimit të ZRRUM-it me të cilin vendim ka refuzuar kërkesën e KRM, "Uniteti", Mitrovicë, për lëshimin e Licencës së Shërbimit për Operimin e Deponisë së Mbeturinave "Gërmova", për shkak se, sipas ZRRUM-it, KRM, "Uniteti", Mitrovicë, nuk i ka përmbushur të gjitha kriteret ligjore për të marrë Licencën e Shërbimit. Ashtu sikurse e përcakton neni 34. 2 i Ligjit Nr 03/L-086, Komisioni Shqyrtues, në përbërje të Kryesuesit të emëruar prej Kuvendit të Kosovës, përfaqësuesit të KRM, "Uniteti", Mitrovicë, dhe përfaqësuesit të ZRRUM-it, pas miratimit të procedurës së punës, i ka ofruar mundësinë palëve të prezantojnë argumentet e veta. Në dëgjim, palët nuk kanë lëvizur nga pozicionet e tyre. Komisioni Shqyrtues ka shqyrtuar një nga një argumentet e ZRRUM-it lidhur me mos lëshimin e Licencës së Shërbimit. Dhe, pas shqyrtimit të vendimit, ankesës, prezantimit të argumenteve, Komisioni Shqyrtues ka konstatuar se një pjesë e argumenteve që i ka dhënë ZRRUM-i në vendim nuk qëndrojnë, disa argumente qëndrojnë pjesërisht, dhe disa argumente tjera lidhur me pronën, licenca dhe lejet tjera relevante nga Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor, mungesa e sigurimit të punëtorëve, struktura e organizimit, procedurat, etj., vazhdojnë të qëndrojnë. Për këtë arsye, Komisioni Shqyrtues ka vendosur të mbetet në fuqi vendimi i ZRRUM-it, mirëpo ka ndryshuar arsyetimin e këtij vendimi.

4.2. MBËSHTETJA INSTITUCIONALE NGA DONATORËT

- ZRRUM ka ndërtuar raporte të shkëlqyeshme të bashkëpunimit me të gjitha institucionet donatore në Kosovë..

Zyra Ndërlidhëse e Komisionit Evropian (ZNKE) e ka mbështetur aplikacionin e ZRRUM të bërë në vitin 2009, për mbështetje institucionale të ZRRUM gjatë viteve 2010- 2012.

Projekti ka filluar me 31 Maj 2010. Financohet nga BE, menaxhohet nga ZNKE, dhe implementohet nga konzerciumi I IPA-as.

Gjatë 2011, Projekti mbështetës për ZRRUM, i financuar nga KE dhe menaxhuar nga ZNKE, në bashkëpunim me ZRRUM ka realizuar aktivitetet në vijim:

- Rishqyrtimi i fletës raportuese të të dhënave vjetore, e cila është në pajtim të plotë me Kontabilitetin Rregullator në bazë të së cilës janë dakorduar caqet për periudhën 2012-2014
- Sigurimi i mbështetjes KRU në plotësimin e raporteve mujore
- Rishqyrtimi i treguesve të performancës, të cilët i mundësojnë ZRRUM të monitorojë performancën e Kompanive të Ujit kundrejt caqeve të përcaktuara gjatë procesit tarifor
- Auditimi/verifikimi i të dhënave financiare të raportuara nga Kompanitë e Ujit
- Përgatitja e Raportit Vjetor të Performancës 2010
- Përgatitja e Mësimeve të nxjerrura nga Monitorimi i Performancës 2010
- Rishqyrtimi i Rregullores për Standardet e Shërbimeve
- Rishqyrtimi i Rregullores për Komisionet Këshilluese të Konsumatorëve
- Rishqyrtimi i Strategjisë së Komunikimit të ZRRUM
- Përgatitja e Modelit të ri të Biznes Planit Rregullator dhe atij Tarifor
- Përgatitja e Udhëzuesit për përdorimin e Biznes Planit Rregullator
- Përgatitja e Udhëzimeve të Kontabilitetit Rregullator
- Përgatitja e Proceduarave për Rishikimin Tarifor 2012-2014
- Përgatitja e Raportit të detajuar në lidhje me përmirësimin e Efiçencën në Faturim dhe Arkëtim nga KRU
- Përgatitja e Raportit të detajuar në lidhje me Planifikimin e Menaxhimit të Aseteve për të u përdorur nga KRU
- Realizimi i vizitës studimore në Britani të Madhe. Përgatitja e Raportit të vizitës studimore
- Sigurimi i mbështetjes KRU në përgatitjen e Bisnes Planeve Rregullatore 2012-2014
- Sigurimi i mbështetjes KRU në përmirësimin e efikasitetit të arkëtimit

- Sigurimi i mbështetjes KRU në përgatitjen e Kontove Rregullatore (Zhvlerësimi sipas kostos aktuale; Baza Rregullatore e Aseteve; dhe Borxhet e Konsumatorëve)
- Organizimi i tri Punëtorive të jashtme:
- Organizimi i tri Punëtorive të brendshme:
- Prezantimi në dy Punëtori të organizuara nga akterët tjerë të ujit
 - o Komisionet Këshilluese të Konsumatorëve – operimet dhe sfidat
 - o Këmbimi i Përvojave në mes të Rregullatorit të Shqipërisë dhe Kosovës
- Ofrimi i mbështetjes Ad hoc për ZRRUM në lidhje me çështje të ndryshme sipas kërkesës së Drejtorit të ZRRUM

5. Relacionet e Jashtme

5.1. BASHKËPUNIMI ME RREGULLATORËT DHE INSTITUCIONET TJERA NË KOSOVË

Në pajtim me orientimet strategjike të ZRRUM për bashkëpunim të hapur dhe të mirëfilltë me të gjitha palët e interesit të sektorit të ujit dhe mbeturinave në Kosovë, e me qëllim të koordinimit të aktiviteteve për arritjen e përmirësimeve të nevojshme në këta sektorë, ZRRUM edhe në vitin 2011 ka vazhduar qasjen e tij të hapur dhe bashkëpunuese me rregullatorët tjerë të këtyre sektorëve, si dhe me palët tjera të interesit.

(i) Bashkëpunimi me Institutin Kombëtar të Shëndetësisë Publike të Kosovës (IKSHPK)

Në bazë të Memorandumit të Bashkëpunimit që kemi nënshkruar me IKSHPK në vitin 2007, ZRRUM ka vazhduar bashkëpunimin e shkëlqyeshëm në fushën e monitorimit të standardeve të kualitetit të ujit të pijes që ofrojnë kompanitë publike të licencuara.

Përpos takimit të rregullt vjetor që kemi pasur në muajin shkurt, bashkëpunimi ka konsistuar në shkëmbimin e rregullt të informacioneve me interes të dy palëve. Në këtë plan, në Raportin Vjetor të Performancës 2011 për kompanitë e ujësjellësit, ZRRUM ka shfrytëzuar të dhënat e IKSHPK.

(ii) Bashkëpunimi me Ministrinë e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor (MMPH)

Duke pasur parasysh rolin e MMPH si autoritet kryesor për menaxhimin e resurseve ujore në Kosovë dhe si rregullator mjedisor i sektorit të ujit dhe mbeturinave, ZRRUM edhe gjatë vitit 2010 ka vazhduar bashkëpunimin me MMPH në sektorët e ujit dhe mbeturinave.

ZRRUM ka pasur disa takime me Ministrin e MMPH në të cilat janë diskutuar problemet aktuale në sektorin e ujërave dhe në veçanti atë të mbeturinave dhe me këtë rast janë diskutuar edhe çështjet që lidhen me harmonizimin e legjislacionit në këta sektorë me qëllim të përcaktimit të qartë të rolit dhe përgjegjësiwe institucionale në sektorin e ujit dhe mbeturinave.

(ii) Bashkëpunimi me Njësinë për Politika dhe Monitorim (NJPM) të MEF

Pas marrjes së përgjegjësiwe nga MZHE, respektivisht nga Njësia për Politika dhe Monitorim (NJPM) në pajtim me Ligjin Nr. 03/L-087 për Ndërmarrjet Publike, ZRRUM ka vazhduar bashkëpunimin me këtë subjekt në të cilat janë diskutuar problemet e shfaqura në operimin e ndërmarrje publike qendrore.

Gjatë vitit 2011, kemi zhvilluar shumë takime të përbashkëta, duke përfshirë edhe uorkshope, dhe Udhëheqësi i NJPM, është edhe anëtar i Këshillit Drejtues në Projektin tonë dyvjeçar, e kjo me qëllim të bashkëpunimit të ndërsjellët, dhe avancimit pozitiv të Kompanive Publike.

(iii) Bashkëpunimi me Palët tjera

Në vitin 2011, ZRRUM ka bashkëpunuar edhe me palët tjera të interesit, në kuadër të domenit të përgjegjësiwe të veta. Vlen të përmendet këtu bashkëpunimi me:

- Takim me Ministrin e ZHE, rrethe implementimit të Vendimit të Qeverisë së Kosovës Nr. 06/18.
- Ministrinë për Integritet Evropian (MIE) në lidhje me hartimin e Planit të Veprimit të Partneritetit Evropian (PVPE), si dhe raportim për Dialogun e Procesit të Stabilizim Asociimit (DPSA).

- Bashkëpunimi me Task Forcën e Ujit (TFU) në lidhje me Adresimin e krijimit të Politikave për Subvencionimin e Rasteve Sociale etj.
- Bashkëpunimi me Ministrinë e Ambientit dhe Planifikimit Hapësinor (MAPH), në aspektet e resurseve ujore, Amandamentimin e Ligjit të Mbeturinae.
- Agjencinë Kosovare për Mbrojtjen e Mjedisit (AKMM).
- Asociacionin e Komunave të Kosovës; dhe me
- Përfaqësuesit e donatorëve (ZNKE, USAID, KFW, SCO, GTZ etj.) dhe konsulentëve që kanë qenë aktiv në sektorin e ujërave dhe mbeturinae në Kosovë.

Me të gjitha këto palë, qoftë në takime të drejtpërdrejta apo në punëtori dhe konferenca, janë diskutuar zhvillimet në sektorët e ujit dhe mbeturinae dhe është paraqitur qëndrimi i ZRRUM lidhur me problemet aktuale në këta sektorë.

5.2. BASHKËPUNIMI ME RREGULLATORËT E UJIT NË REGJION DHE NË EVROPË

Bashkëpunimin me rregullatorët tjerë të sektorit të ujërave, ZRRUM e konsideron me rëndësi vitale, për shkëmbimin e përvojave dhe për adoptimin e praktikave të mira në fushën e zbatimit të rregullimit ekonomik të shërbimeve të ujit.

- Në këtë plan, në vitin 2011 ZRRUM ka vazhduar të bashkëpunojë me rregullatorin ekonomik të shërbimeve të ujit të Shqipërisë (ERRU), bashkëpunim ky i iniciuar më herët, e që është formalizuar me një Marrëveshje Bashkëpunimi në vitin 2009. Kemi pasur një vizitë pune, dhe shkëmbim të stafit.
- Në anën tjetër, bashkëpunimi me rregullatorin e shërbimeve të ujit të Portugalisë i iniciuar në fund të vitit 2007, ka vazhduar me shkëmbimin e informacioneve si dhe me shkëmbimin e Raportit Vjetor të Performancës 2010 të Kosovës, respektivisht Portugalisë.
- Në vitin 2011 kemi pasur një takim të përbashkët me Kryetarët e Rregullatorit të Shqipërisë dhe Portugalisë, në Shqipëri, ku është diskutuar për përvojat dhe sfidat e Rregullatorëve në rajon.
Është organizuar një vizitë studimore në Mbretërinë e Bashkuar, në Entin Rregullator OFWAT, dhe në disa Kompani të Ujit. Pjesëmarrës nga ZRRUM, NJPMNP, dhe dy përfaqësues të KRU, me ç'rast është marrë një përvojë se si menaxhohet Uji dhe jemi informuar rreth punës së Rregullatorit të Ujit në Mbretërinë e Bashkuar. Të gjitha shpenzimet kanë qenë të Projektit në fjalë.

5.3. BASHKËPUNIMI ME MEDIA - RELACIONET ME PUBLIKUN

Duke pasur parasysh faktin se koncepti i rregullativës ekonomike të shërbimeve publike është koncept relativisht i ri në Kosovë dhe rrjedhimisht njohuritë e përfaqësuesve të institucioneve Kosovare dhe publikut të gjerë për këtë koncept janë mjaft të kufizuara, ZRRUM në vitin 2011 është angazhuar që përmes formave të ndryshme të ndikojë në njoftimin e institucioneve dhe publikut të gjerë, për atë se çfarë është roli dhe funksioni i rregullativës ekonomike që e zbaton ZRRUM. Gjatë vitit 2011, kemi lëshuar disa komunikata për Shtyp dhe intervista në televizion, kryesisht rreth përcaktimit të tarifave dhe të gjitha informacioneve që janë publikuar në Ueb Faqen e ZRRUM-it.

6. Aspektet Financiare

Në bazë të Ligjit Nr. 03/L-086 (neni 8.4), si burim kryesor për financimin e aktiviteteve të ZRRUM janë taksat e licencimit që i paguajnë ofruesit e licencuar të shërbimeve të ujësjellësit dhe mbeturinave. Lartësia e taksave të licencimit caktohet në bazë vjetore sipas kriterave vijuese:

- të hyrat nga këto taksa duhet të korrespondojnë me shpenzimet e planifikuara të ZRRUM për vitin aktual, me kusht që
- lartësia e taksës mos të tejkalojë 1.5% të qarkullimit bruto vjetor të ofruesve të shërbimeve.

Po ashtu, projekte dhe aktivitete të caktuara të ZRRUM mund të financohen nga donacionet e agjencive donatore si dhe nga grandet qeveritare.

Buxheti vjetor i ZRRUM aprovohet nga Kuvendi i Kosovës. Me rastin e parashikimit të shpenzimeve të veta ZRRUM udhëhiqet nga parimet e operimit eficient financiar me qëllim që rregullimi ekonomik i shërbimeve të ujësjellësit dhe mbeturinave të mos ketë kosto të lartë për konsumatorët.

6.1. SHPENZIMET

Edhe pse ZRRUM të gjitha transaksionet financiare i kryen përmes barazimeve mujore të sistemit të Thesarit, ZRRUM mban kontabilitetin e vet financiar dhe material.

Për vitin fiskal 2011, ZRRUM ka pasur në dispozicion mjete financiare në lartësi 326,528.00 EUR,.

Në tabelën më poshtë (Tabela 29) është dhënë një pasqyrë e burimeve financiare që ka pasur në dispozicion ZRRUM në vitin fiskal 2011 si dhe shpenzimeve të realizuara.

Tabela 29: Buxheti i ZRRUM për 2011

Kategoria e Shpenzimeve	Të buxhetuara (EUR)	Të realizuara (EUR)
Paga dhe Mëditje	162,400.00	156,494.10
Mallra dhe shërbime	157,520.00	112,303.00
Shpenzime Kapitale	-	-
Shërbimet Komunale/Publike	6,650.00	4,526.00
Total Buxheti	326,570.00	273,323.00

ZRRUM buxhetin e vitit 2011 e ka shpenzuar ne % 83,67%

6.2. MBËSHTETJA NGA DONATORËT

Duhet të theksohet se përpos këtyre mjeteve, ZRRUM në vitin 2011 ka pasur mbështetje institucionale nga donatorët në formën e asistencës teknike Prej datës 16 korrik 2010, ZRRUM ka pasur mbështetje nga projekti i IPA në vlerë prej 1.8 mil.€, (të cilat ZRRUM nuk i posedon meqenëse menaxhimi financiar i projekteve është bërë nga vet donatorët).

6.3. TË HYRAT NGA TAKSAT E LICENCIMIT 2011

ZRRUM për vitin 2011 ka planifikuar të inkasoj 327,364.46 euro nga kompanitë e licencuara në sektorin e ujësjellësit dhe kompanitë e grumbullimit të mbeturinave, prej të cilave ka inkasuar 238,960.01 euro apo në % ka inkasuar 72,99% të të hyrave të planifikuara.

Vlen të theksohet se ZRRUM për vitin 2011 nga kompanitë e licencuara në sektorin e ujësjellësit dhe kanalizimit ka inkasuar 100% të taksës së licencimit të planifikuar për vitin 2011, ndërsa te kompanitë e licencuara për grumbullimin e mbeturinave edhe pse është arritur një ngritje prej 7.24% krahasuar me vitin 2010 ku shkalla e inkasimit ka qenë 12.31%, tani ka arritur në 19.55% por ende nuk jemi të kënaqur.

Nga Planifikimi i inkasimit të taksës së licencimit për vitin 2011 nga kompanitë e licencuara për grumbullimin e mbeturinave në vlerë prej 109,900. euro ZRRUM ka inkasuar 21,496.01 euro apo në % 19.55%.

Arsyeja e mos inkasimit të taksës së licencimit nga ana e ZRRUM-it ka qenë shkalla shumë e ulët e inkasimit të këtyre kompanive, neglizhenca ndaj ZRRUM-it, Amandamentimi i ligjit të mbeturinave (i cili krijoi mëdyshje te këto kompani), si dhe vështirësitë e tjera financiare që po i përcjellin këto kompani.

Borxhlinjtë e ZRRUM-it për vitin 2011

KRM 'EKOREGJIONI'	18,489.64 €
KRM 'PASTRIMI'	35,451.91 €
KRM 'UNITETI'	9,512.44 €
KRM 'PASTËRTIA'	8,536.45 €
KMDK	6,871.27 €
KRM 'ÇABRATI'	6,348.13 €
KRM HIGJENA	7,552.70 €
KRM 'AMBIENTI'	5,432.40 €
Gjthsejt borxhi	97,163.08 €

Borxhlinjtë e ZRRUM-it për vitin 2011 janë të gjitha kompanitë e licencuara që ofrojnë shërbimet e grumbullimit të mbeturinave.

Për vitin 2011 KRM Ekoregjioni nuk ka bërë asnjë pagese, dhe si masë për inkasimin e mjeteve, ZRRUM është në përgatitje të dokumentacionit për iniciimin e lëndës në gjykatën kompetente

6.4. ASETET E ZRRUM

Duke pasur parasysh ligjet e zbatueshme në Kosovë mbi themelimin e institucioneve të Kosovës, pastaj Buxhetin e Konsoliduar të Kosovës si dhe Rregulloret e Thesarit, institucionet buxhetore vetë e bëjnë regjistrimin e aseteve, ndërsa amortizimin e tyre e bën departamenti i Thesarit.

Vlera e aseteve në ZRRUM që nga viti 2005 e deri me 31.12.2011 është: 52,645.00 EUR.

7. REKOMANDIME TË PËRGJITHSHME

Me qëllim të avancimit të sektorit të shërbimeve të ujit dhe të ujërave të zeza, nga ZRRUM dhe nga institucionet, të cilat kanë përgjegjësinë në këtë sektor, rekomandohet të ndërmerren masat në përputhje me përgjegjësitë respektive, ligjore dhe institucionale. Besojmë që këto rekomandime të aprovohen nga Komisioni FunkSIONAL i Kuvendit.

Qeveria: duhet të vendosë sektorin e shërbimeve të ujit dhe të mbeturinave në kuadër të prioritetëve të saja dhe të angazhohet në drejtim të:

- Alokimit të Investimeve në sektorin e ujit e sidomos, orientimi i tyre në investime për ngritjen e kapaciteteve të prodhimit të ujit,
- Ngritja e kapaciteteve monitoruese dhe mbikëqyrëse të institucioneve për të garantuar kualitetin e ujit të pijshëm,
- Ndërmarrja e masave të duhura në ngritjen e efikasitetit të faturimit dhe arkëtimit të faturave për shërbimet e ofruar e cila është identifikuar si një prej sfidave të Raportit të Progresit të Komisionit Evropian,
- Vazhdimi i procesit të Konsolidimit/Ristrukturimit të sektorëve të shërbimeve të ujit si dhe integrimi i njësive operative të ujësjellësve në kuadër të Kompanive Rajonale respektive,
- Integrimi i skemave të ujësjellësve ruralë në kuadër të ujësjellësve qendror të cilat aktualisht menaxhohen nga komuniteti,
- Subvencionimi i faturave për shërbimet e ujit për konsumatorët të cilët janë në gjendje të rendë sociale.

Komunat: rekomandohet të respektojnë obligimet e saja karshi sektorit të ujit dhe të mbeturinave, duke:

- Koordinuar aktivitetet me Kompanitë Rajonale për orientimin e investimeve për të zgjeruar ofrimin e shërbimeve në zona të reja të zhvillimit të komunës,
- Ndihmuar kompanitë e shërbimeve të ujit dhe të mbeturinave në arkëtimin e borxheve për shërbimet e ofruara,
- Hartimin e planeve për menaxhimin e mbeturinave komunale.

KRU: Rekomandohet që të ndërmarrin aktivitete të shtuara në drejtim të ngritjes së nivelit të shërbimit ndaj konsumatorëve, sidomos duke u fokusuar në çështjet vijuese:

- Përpilimi i planeve dhe intensifikimi i aktiviteteve për të ulur nivelin e ujit të pa faturuar (UPF) i cili aktualisht është në nivel të pa akceptueshëm,
- Përmirësimi i efikasitetit të mbledhjes së faturave si dhe rritja e Shkallës së Arkëtimit,
- Përmirësimi i Orarit të furnizimit përmes reduktimit të ndërprerjeve të ujit,
- Të ngritet kualiteti i ujit të furnizuar për të plotësuar standardet e ujit të pijshëm,
- Vazhdimi i instalimit të ujëmatësve, mirëmbajtja dhe kalibrimi i tyre në mënyrë që konsumatorët të kenë një faturim sa më të saktë,
- Përmirësimi i marrëdhënieve me konsumatorë përmes azhurnimit të shqyrtimit dhe zgjedhjes së ankesave dhe kërkesave të tyre.

ZRRUM, si institucion me përgjegjësi rregullatore në sektorin e shërbimeve të ujit dhe të mbeturinave rekomandohet të ndërmerret hapat në drejtim të:

- Zhvillimit dhe intensifikimit të mëtutjeshme të monitorimit të ofruesve të licencuar të shërbimeve, si dhe sigurimi i presionit të duhur për të arritur objektivat e përcaktuar përmes procesit tarifor,
- Promovimi, në një nivel më të lartë, të interesave të konsumatorëve përmes adresimit të çështjeve, të pa zgjidhura në mes të konsumatorëve dhe ofruesve të këtyre shërbimeve.